


Raiffeisen Bank Shqipëri

Raport Vjetor 2019

Përmbytje

RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE	6
MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM	7
MISIONI	8
PERSPEKTIVAT DHE PLANET PËR VITIN 2020	9
ORGANET DREJTUESE TË BANKËS	10
RAPORTI I BORDIT DREJTUES	12
Zhvillimet Ekonomike	12
Rezultatet Financiare	13
Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut	17
RAPORTI I SEGMENTEVE	18
Segmenti Korporatë	18
Segmenti i Bizneseve të Vogla (SE)	18
Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE	19
RETAIL BANKING	21
Zhvillimi i Segmenteve	21
Divizioni i Produkteve	22
Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik	23
Eksperienca e klientit	25
Kanalet e Shpërndarjes	26
THESARI DHE BANKINGU I INVESTIMEVE	28
Të ardhurat fikse	28
Tregu i parasë	28
Këmbimi valutor	29
Shitjet e thesarit	29
PËRGJEGJËSI SOCIALE	30
BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMET	32
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	38
RAIFFEISEN LEASING SH.A	122
RAIFFEISEN INVEST SH.A	124
NJË VËSHTRIM MBI RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL	126
RRJETI I RAIFFEISEN BANK SHA	127
ADRESA	128





Raporti i Këshillit Drejtues

Zonja dhe Zotërinj,

Viti financiar 2019 ishte një vit tepër i suksesshëm për Bankën Raiffeisen në Shqipëri, dhe unë dëshiroj të shpreh kënaqësinë tonë për rezultatet dhe progresin e arritur.

Gjatë vitit financiar 2019, Këshilli Drejtues ka zhvilluar katër mbledhje. Niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Drejtues ka qenë 85 përqind. Në periudhat midis mbledhjeve Këshilli Drejtues ka marrë vendime çarkulluese kur ka qenë e nevojshme.

Këshilli Drejtues ka monitoruar rregullisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e Raiffeisen Bank sh.a dhe zhvillimet e rrezikut brenda saj. Janë zhvilluar rregullisht diskutime me anëtarët e Drejtorisë në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe mbi drejtimin e aktivitetit të bankës dhe strategjitë e rrezikut. Këshilli Drejtues ka shqyrtuar gjithashtu në mënyrë të hollësishme zhvillimet e mëtejshme në lidhje me qeverisjen e korporatës dhe ka monitoruar zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë veprimtarisë së tij monitoruese dhe këshilluese, Këshilli Drejtues ka mbajtur kontakte të drejtpërdrejta me anëtarët përgjegjës të Drejtorisë, audituesin, si dhe drejtuesit që janë përgjegjës për funksionet e kontrollit të brendshëm. Ai gjithashtu ka pasur një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni dhe pikëpamjesh me përfaqësuesit e autoriteteve mbikqyrëse për çështje me rëndësi.

Gjithashtu, Drejtoria i ka paraqitur Këshillit Drejtues raporte të rregullta dhe të hollësishme për çështje të rëndësishme në lidhje me performancën në fushat përkatëse të aktivitetit të bankës. Në periudhat ndërmjet mbledhjeve Këshilli Drejtues ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Kryetarin dhe anëtarët e Drejtorisë. Ata kanë qenë të disponueshëm sa herë që u janë kërkuar diskutime dypalëshe ose shumëpalëshe me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe, sipas rasti, me pjesëmarrjen e ekspertëve për çështjet që janë ngritur.

Puna e ndërmarrë së bashku me anëtarët e Drejtorisë është bazuar në një marrëdhënie besimi të ndërsjellë dhe është zhvilluar në një frymë bashkëpunimi efikas dhe konstruktiv. Diskutimet kanë qenë të hapura dhe kritike dhe Këshilli Drejtues i ka miratuar rezultatet, pasi i ka shqyrtuar ato plotësisht në të gjitha aspektet. Në rastet kur anëtarët e Këshillit Drejtues kanë kërkuar informacion shtesë për shqyrtimin e çështjeve të caktuara më në hollësi, ai u është vënë në dispozicion pa vonesë dhe sipas kërkesave së tyre.

Këshilli Drejtues ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në legjislacionin bankar shqiptar, statutin e bankës dhe rregulloren e Këshillit Drejtues. Gjatë mbledhjeve tremujore ai ka diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me bankën duke u kushtuar vëmendje të veçantë në formën e 'temave në fokus'.

Dëshiroj të përfitoj nga rasti për të falënderuar klientët tanë për besimin e tyre të vazhdueshëm dhe të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank sh.a për punën e tyre të palodhur dhe përpjekjet e palëkundura gjatë vitit 2019, si dhe për të kërkuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm për të përballuar çdo sfidë që po kalojmë.

Në emër të Këshillit Drejtues



Peter Lenkh,
Kryetari



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

Viti financiar 2019 ishte vërtet një vit me arritje të kënaqshme për Bankën Raiffeisen, me rezultate shumë të mira në shumë tregues të performancës. Falë kontributit të të gjithë segmenteve të aktivitetit tonë, fitimi përpara tatimit u rrit me 1.6 përqind. Kreditë për individët arritën vlerën 280 milionë euro, duke rritur kështu praninë tonë në tregun e kredive për individë në 21 përqind, me theks në vëllimet e reja të kredive pa kolateral, të cilat arritën një të tretën e vëllimeve të reja të tregut.

Kanali i banking-ut digjital Raiffeisen ON shënoi një performancë të shkëlqyer. Numri i klientëve të abonuar u rrit ndjeshëm, me individë dhe subjekte të cilët e kanë kthyer atë në platformën digjitale më të përdorur dhe më të shkarkuar nga interneti: në total 127 mijë klientë ku mbi 50% janë përdorues aktivë. Me qëllimin strategjik drejt transformimit digjital, Raiffeisen ON është pasuruar me veçori dhe funksione të reja që mundësojnë një banking të lehtë dhe me më shumë leverdi për klientët tanë, me vizionin e qartë për të qenë grupi më i rekomanduar bankar. Po ashtu, asistentja virtuale RONA, i vetmi chatbot bankar në tregun shqiptar, është përmirësuar në mënyrë që t'u përgjigjet më shumë pyetjeve të klientëve dhe të përmbush kërkesat e tyre në rrjetet sociale më të përdorura (Viber, Whatsapp, Messenger).

Raiffeisen Bank sh.a u shërben me kënaqësi më shumë se 437,000 klientëve në të gjithë vendin, duke ju ofruar atyre një diapazon të gjerë zgjidhjesh novatore dhe produktesh bankare. Infrastruktura e degëve është modernizuar, ku klientët shërbehen nga një staf tejet i trajnuar, gjithmonë i gatshëm për të ofruar një shërbim të shkëlqyer si në degë edhe me shërbimet online.

Vijojmë të zotërojmë rrjetin më të madh të degëve dhe ATM-ve në vend, si dhe kemi shtuar Zonën e Vetëshërbimit në degët kryesore, për të mundësuar transaksionet monetare dhe jomonetare 24 orë në ditë, çdo ditë të javës.

Segmenti i korporatave ka shënuar një performancë mjaft të lartë për vitin 2019. Baza e huadhënies është rritur me 10 përqind. Vëllimi i aktiveve shënoi një rritje prej 6.7 përqind krahasuar me një vit më parë, dhe të ardhurat bruto shënuan një performancë të lartë, me 22 përqind mbi atë të buxhetuar. Këto rezultate janë arritur falë angazhimit të menaxherëve të marrëdhënies me klientët, të cilët kanë ofruar shërbime specifike dhe përmirësuar kohën e kthimit të përgjigjeve, me qëllim krijimin e partneriteteve me bizneset dhe formimin e vlerave të qëndrueshme.

Për Raiffeisen Leasing sh.a. viti financiar 2019 ka qenë viti më i suksesshëm që nga nisja e veprimtarisë së saj. Shoqëria ruajti pozicionin e saj dominues me 40 përqind të tregut të qirasë financiare në vend dhe mbetet shoqëria e parapëlqyer për subjektet tregtare dhe individët që kërkojnë financime për makineri, pajisje, linja prodhimi, makina dhe automjete.

Raiffeisen INVEST sh.a., mbeti shoqëria udhëheqëse në administrimin e pasurive në tregun financiar shqiptar, duke zotëruar jo më pak se 96 përqind të saj. Viti 2019 u mbyll me më shumë se 522 milion euro asetë të investuara në fondet vullnetare të pensioneve. Gjatë vitit 2019 Raiffeisen Invest sh.a hodhi hapin e parë drejt digjitalizimit. Shoqëria integroi me sukses bazën e plotë të të dhënave në platformën digjitale Raiffeisen ON, duke i mundësuar çdo klienti përdorimin me lehtësi të llogarive të tyre të investimit përmes banking-ut me telefon celular smart.

Pavarësisht situatës së re me të cilën po përballlet e gjithë bota aktualisht, ne mbetemi optimistë. Padyshim, nuk presim që viti 2020 të jetë një vit pa sfida, duke pasur parasysh pasiguritë në shumë sektorë të ekonomisë në botë. E megjithatë, ne do të vijojmë të japim kontributin tonë në ekonominë e vendit dhe të sjellim produktet dhe shërbimet më novatore për klientët tanë përmes transformimit të vazhdueshëm digjital, për ta bërë banking-un sa më të përshtatshëm për ta.

Në mbyllje, në emër të Bordit Drejtues, dua të shpreh mirënjohjen time të singertë për të gjithë klientët dhe partnerët e biznesit për bashkëpunimin e tyre gjatë 2019-tës. Ashtu si, dua të falenderoj edhe të gjithë stafin për dedikimin e tyre, profesionalizmin dhe fokusin tek klienti. Falë përkushtimit të tyre ne do të vazhdojmë të ofrojmë një shërbim të shkëlqyer për klientët tanë korporatë, SME si edhe individë, në mënyrë që Raiffeisen Bank sh.a të bëhet zgjedhja e parë bankare në sektorin vendas.



Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm

Kryetar i Drejtorisë



Vizioni & Misioni

Vizioni ynë:

Të jemi grupi më i rekomanduar për shërbimet financiare deri në 2025.

Misioni ynë:

Të transformojmë inovacionin e vazhdueshëm në një eksperiencë të shkëlqyer për klientët tanë.

Vlerat



Bashkëpunim

Kur punojmë bashkë, komunikojmë bashkë, dëgjojmë dhe mbështesim njëri tjetrin ajo ç'ka mund të arrijmë do jetë shumë e madhe. Ne po ndërtojmë një mjedis mirëkuptimi, respekti dhe besimi reciprok.




Proaktivitet

Ne besojmë tek vizioni ynë për të ardhmen. Nxsim ndryshimin duke u përqendruar tek mundësitë dhe jo pamundësitë. Shkëmbejmë pavendosmërinë me vendosmërinë. Veprojmë, nuk reagojmë.



Të mësuarit

Të mësuarit e vazhdueshëm do të thotë zhvillim personal. Mësojmë nga eksperiencia, edukimi dhe ndarja e dijeve me njëri-tjetrin.



Përgjegjshmëri

Kur çdonjëri nga ne mbart përgjegjësi për atë çka bën ndryshimi është i madh. Vetëm dhe së bashku jemi përgjegjës për vendimet, rezultatet dhe pasojat e veprimeve tona.

Perspektivat dhe Planet për Vitin 2020

Për vitin 2020, Banka Raiffeisen planifikon të avancojë me zhvillimin e saj dhe të kontribuojë më tej në ekonominë e vendit. Në përgjigje të ndryshimit të rrethanave ekonomike dhe të sjelljes së konsumatorit për shkak të pandemisë globale të vitit 2020 dhe ndryshimit të pritshmërive të klientëve, peisazhi do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme dhe do të përshtatet me këtë mënyrë të re jetese.

Ne do të vijojmë të përqendrohemi në të gjithë segmentet tona të marrëdhënieve me klientin: shërbimet për individët, korporatat, SE dhe Mikro, duke investuar në teknologji, produkte dhe shërbime të reja, si dhe duke ofruar standardin më të lartë të shërbimit ndaj klientit.

Transformimi digjital do të vijojë të zhvillohet dhe të jetë pjesë e të gjithë segmenteve tona bankare si një mundësi për të rritur vlerën e klientit në këtë kontekst të trazuar. Ne do të vijojmë të investojmë në platformat tona digjitale për të ruajtur rolin drejtues si banka më novatore dhe e përparuar në vend. Në këtë këndvështrim, ne do të vazhdojmë të pasurojmë platformën tonë digjitale Raiffeisen ON me veçori dhe funksione të reja për të lehtësuar shërbimet bankare për klientët tanë. Për më tepër dhe, në dritën e marrëdhënieve personale me klientët premium, ne do të prezantojmë për herë të parë platformën Rai connect, ku secili klient mund të flasë dhe të këshillohet përmes komunikimit me video drejtpërdrejt me menaxherin e marrëdhënieve me klientin. Mënyra të reja pagese do të prezantohen për klientët individë si me prezantimin e robotit tonë unik RONA, asistentja virtual bankar e vetme në treg, do të vazhdojë të pasurohet më tej me funksione për t'iu përgjigjur më mirë të gjitha kërkesave të klientëve në kohë reale.

Po ashtu, cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjithë segmentet tona do të vijojë të mbetet përparësi e jona. Segmenti Retail do të vazhdojë të përqendrohet në ofrimin ndaj klientëve të produkteve dhe shërbimeve më të mira në treg, si shërbimet e banking-ut digjital, metodat novatore të pagesave, huatë për konsumatorët, etj.

Për më tepër, ne do të vijojmë t'iu shërbejmë klientëve tanë Korporata dhe SE duke integruar në këtë segment oferta digjitale dhe do të vijojmë të ofrojmë një gamë të gjerë shërbimesh bankare të personalizuar, si për bizneset ashtu edhe për punonjësit e tyre.

Ne do të vijojmë të përqendrohemi në trajnimin dhe zhvillimin personal të punonjësve tanë, në mënyrë që të arrijmë standardet më të larta të shërbimit ndaj klientit. Në të njëjtën kohë do të vazhdojmë të përmirësojmë rrjetin e degëve në përputhje me transformimet digjitale, në mënyrë që të kemi degë moderne dhe sa më akomoduese për klientin.


Mbetemi plotësisht të përkushtuar për të përmbushur kërkesat në fushën e banking-ut dhe në ofrimin e një shërbimi me cilësi të lartë në çdo pikë kontakti të klientëve me bankën tonë, duke u përmirësuar në leximin e sinjaleve të ndryshimeve të jemi më elastik dhe më të shkathët në përgjigjen ndaj kushteve të tregut.

Bordi Drejtues
Raiffeisen Bank Sh.a



Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai

Zëvendës Drejtor i
Bordit Drejtues



Lyubomir PUNCHEV

Anëtar Bordi për
Shërbimet ndaj
Individëve



Elona Mullahi (Koçi)

Anëtare Bordi për
Korporatat & SE



Egon Lerchster

Anëtar Bordi për TI &
Operacionet

Organet Drejtuese të Bankës

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues është përgjegjës për miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor, përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave, monitorimin e efikasitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave, etj.

Anëtarët e Këshilli Drejtues

Peter Lennkh	Kryetar
Heinz Wiedner	Zëvendëskryetar
Slavoljub Dordevic	Anëtar
Harald Kreuzmair	Anëtar
Andreas Engels	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Komiteti i kontrollit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte; bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar, etj.

Anëtarët e Komitetit të Kontrollit

Heinz Wiedner	Kryetar
Johannes Kellner	Zëvendëskryetar
Susanna Benoit	Anëtar

Komiteti i Rrezikut

Komiteti i Rrezikut këshillon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues në lidhje me strategjinë dhe oreksin e përgjithshëm aktual dhe të ardhshëm të rrezikut, si edhe ndihmon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues për të mbikëqyrur zbatimin e kësaj strategjie nga drejtuesit e lartë të bankës.

Anëtarët e Komitetit të Rrezikut

Andreas Engels	Kryetar
Harald Kreuzmair	Zëvendëskryetar
Heinz Wiedner	Anëtar

KOMITETI EKZEKUTIV I KREDIVE

Komiteti Ekzekutiv i Kredive miraton dhënien e kredive përfshirë linjat e kredive dhe detyrimet e mundshme ndaj një kredimarrësi të vetëm (ose më shumë se një kredimarrësi të një "subjekti ekonomik), si edhe merr vendime në lidhje me rrezikun e vendit për të cilat kërkohet miratimi i Këshillit Drejtues sipas rregullores së Komitetit të Kredive.

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të Kredive

Andreas Engels	Kryetar
Heinz Wiedner	Zëvendëskryetar
Harald Kreuzmair	Anëtar

DREJTORIA

Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës; përcakton dhe delegon detyrat të personeli, si edhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara; ndërmer masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

Anëtarët e Drejtorisë

Christian Canacaris	Kryetar/Drejtor i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai	Zëvendëskryetar/Zv. Drejtor i Përgjithshëm
Lyubomir Punchev	Anëtar
Elona Mullahi	Anëtar
Egon Lerchster	Anëtar

Raporti i Drejtorisë

Zhvillimet Ekonomike

Ekonomia u ngadalësua në vitin 2019 duke u rritur me 2,95 përqind mesatarisht në tre tremujorët e parë krahasuar me rritjen prej 4.1 përqind që shënoi në 2018-tën. Ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike në 2019-ën erdhi kryesisht nga rënia e prodhimit të energjisë elektrike në pjesën e parë të vitit për shkak të kushteve jo të mira klimatike. Tremujori i tretë shfaqti përmirësim, i mbështetur nga zgjerimi i konsumit dhe eksporteve e veçanërisht nga të ardhurat nga turizmi. Ekonomia pritet të rritet në nivele të ulëta prej 2-2,5 përqind përgjatë vitit 2020, duke vuajtur pasojat e tërmetit dhe përhapjes së korona virusit.

Inflacioni në 2019 rezultoi në ulje në nivelin 1,5 përqind mesatarisht krahasuar me 2,0 përqind që ishte në 2018-tën, duke qëndruar larg objektivit për inflacionin prej 3.0 përqind të Bankës së Shqipërisë. Kontributin më të madh e kishte grupi i ushqimeve. Ndërkohë rënia pasqyroi efektet e mbiçmimit të monedhës vendase, inflacionin e ulët të partnerëve si dhe presionet e ulëta të brendshme të rezultuara nga rritja e pagave dhe e kostove të prodhimit. Politika monetare vazhdoi të ishte stimuluese në 2019-tën me një normë bazë në nivelin më të ulët historik të 1,0 përqind të vendosur që prej qershorit 2017. Në 2020-ën pritet një inflacion mesatar prej 1,4 përqind e për rrjedhojë dhe politika monetare do të mbetet stimuluese ndërsa intensiteti i stimulit monetar do të varet nga zhvillimet e inflacionit dhe të ekonomisë.

Zhvillimet në tregun e punës kanë shfaqur shenja përmirësimi përgjatë 2019-tës. Shkalla e papunësisë në tremujorin e tretë të 2019-ës zbriti në nivelin më të ulët historik prej 11,4 përqind. Punësimi në të njëjtën tremujor u rrit me 3,3 përqind në terma vjetorë dhe sektorët që prodhuan më tepër punësim ishin shërbimet dhe industria.

Konsolidimi fiskal vazhdoi edhe në 2019-ën, ku deficitit buxhetor rezultoi në nivelin e 259 milion euro-ve, ose e vlerësuar në nivelin 1,9 përqind e PBB-së, brenda kërkesës së ligjit organik të buxhetit. Të ardhurat buxhetore u rritën lehtësisht me 2,3 përqind nga viti në vit, por gjithsesi mbetën 5,4 përqind poshtë planit. Edhe shpenzimet buxhetore rezultuan të rritura në krahasim me vitin e kaluar prej 3,3 përqind, megjithatë nën buxhet për shkak të shkurtimeve në shpenzimet aktuale dhe kapitale. Tendencat e raportit të borxhit publik mbi PBB-në vazhdoi të jetë rënëse edhe në 2019-tën. Në fund të vitit 2019, borxhi publik mbi PBB-në rezultoi 65,84 përqind nga 67,85 përqind në 2018-tën.


Pozicioni i jashtëm i vendit u dobësua në nëntëmuorin e parë të 2019-tës, pasi deficitit i llogarisë rrjedhëse rezultoi në nivelin e 687 milion euro-ve, duke u zgjeruar me 39 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Thellimi i deficitit tregtar me 12,8 përqind nga viti në vit është arsyeja kryesore e zgjerimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Pozitivisht ndikuan eksportet neto të shërbimeve të cilat u rritën me 11,9 përqind nga viti në vit në periudhën janar-shtator 2019 me kontribues kryesor turizmin. Në fund të Shtator 2019, investimet e huaja direkte arritën 810 milion euro duke shënuar një rritje vjetore prej 7,4 përqind, e në të njëjtën kohë duke financuar kështu plotësisht deficitin e llogarisë rrjedhëse. Remitancat arritën 520 milion euro deri në Shtator 2019, me një rritje të moderuar prej 3,2 përqind në krahasim me një vit më parë.

Aktiviteti i përgjithshëm i sektorit bankar u zgjerua lehtësisht në 2019 me një rritje vjetore të aktiveve prej 1,6 përqind (0.5 përqind në 2018). Kredi-dhënia shënoi një rritje vjetore negative prej 0,9 përqind pjesërisht për shkak të efektit të vlerësimit të monedhës vendase dhe pastrimit të kredive të këqija nga bilanci. Duke parë drejt 2020-tës, perspektiva e kredi-dhënies mbetet pozitive duke marrë parasysh nivelet e përmirësuar të kredisë me probleme. Në fund të 2019-tës, niveli i kredisë me probleme ra në 8,4 përqind të totalit të kredive nga 11,1 përqind në 2018-tën. Implementimi i masave të marra për uljen e kredive me probleme, vazhdimi i procesit i pastrimit të bilanceve të bankave nga kreditë e humbura dhe përmirësimet në procesin e ristrukturimit ndikuan pozitivisht në uljen e nivelit të kredive të këqija. Sistemi bankar shënoi performancë të mirë financiare në 2019-tën, duke kapur nivelin e fitimit neto prej 163,4 milion euro-ve. Sistemi bankar mbeti likuid dhe i mirë-kapitalizuar në 2019-tën, me raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18,3 përqind krahasuar me minimumin e kërkuar prej 12,0 përqind.

Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2019 ishte 223,828 milion Lekë (2018: 223,180 milion Lekë). Në 2019 portofoli i kredisë, përfaqësonte 42 përqind (2018: 39 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë rreth 28 përqind të totalit të aktiveve në 2019 (2018: 33 përqind).

Struktura e Bilancit - Aktivi
(në '000 LEK)



Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2019 ishte 105,156 milion Lekë (2018: 98,829 milion Lekë) duke përfaqësuar kështu një rritje prej 6 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 49 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe vazhdon të përfaqësojë vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredie prej 51,216 milion Lekë (2018: 50,105 milion Lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rritje në portofolin e kredisë përkatësisht 11 përqind. U shënuan një ulje në portofolin e kredisë prej 28 përqind për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 1,096 milion Lekë (2018: 1,527 milion Lekë).


Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët
(në '000 LEK)



Totali i detyrimeve në fund të vitit 2019 ishte 195,074 milion Lekë (2018: 195,565 milion Lekë). Në 2019, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 96 përqind (2018: 96 përqind) të totalit të detyrimeve.

Struktura e Bilancit - Pasiv


(në '000 LEK)



2019 shënoi një ulje prej 6 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2018 në 3,107 milion Lekë (2018: 3,298 milion Lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 13.34 përqind në 2018 në 10.55 përqind në 2019. Dividend të deklaruar dhe të paguar në 2019 janë 1.964 milion Lekë (2018: 4.094 milion Lekë).


Struktura e Kapitalit Aksioner

(në '000 LEK)




E ardhura neto nga interesat paraqitet e qëndrueshme, ose nga 7,044 milion Lekë në 2018, në 7,057 milion Lekë në 2019. E ardhura nga interesat bashkë me rritjen e bilancit të përgjithshëm të bankës prej 0.3 përqind, ndikoi në rritjen e marzhit të interesit (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) që është 3.16 përqind në 2019 nga 2.97 përqind në 2018.

Të ardhura neto (në '000 LEK)




Shpenzimet administrative në total gjatë 2019 arritën në 1,962 milion Lekë (2018: 2,202 milion Lekë). Efienca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura ndryshoi nga 61.95 përqind në 58.41 përqind. Shpenzimet për stafin u rritën me 2 përqind ose 2,511 milion Lekë në 2019 krahasuar me 2,451 milion Lekë në 2018.

Shpenzime operative 2019 (në '000 LEK)



Fitimi & ROE

(në '000,000 ALL)



Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut

Deklarata e Bankës për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të ndërmarrë, ka për qëllim t'i krijojë drejtuesve të bankës një mundësi menaxhimi dhe kontrolli për të gjithë nivelet e riskut që banka është e gatshme të pranojë në mënyrë që të arrijë objektivat e saj strategjike dhe financiare. Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut të Bankës ka një ndërlidhje me Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, duke qenë se objektivi kryesor i saj është që të ndërlidhi objektivat strategjike dhe financiare me detyrimin për të përmbushur kërkesat rregullatore për mjaftueshmërinë e kapitalit në rast të skenarëve të rënduar ose në rastet e risqeve të caktuara dhe të sigurojë që kreditorët nuk do të mbartin humbje në raste të një risku ekstrem. Banka Raiffeisen, në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë mban një vlerë të caktuar të kapitalit për ta përdorur në rast të risqeve materiale. Për të ashtuajturat risqet e "Shtylla I" (si psh risku i kredisë, risku i tregut dhe riskut operacional), vlerësimi sasior dhe procedurat e përcaktojnë: që shtesa në kapitalin rregullator të përfshijë edhe vlerat nga përlllogaritja e këtyre risqeve. Manaxhimi i riskut në Raiffeisen Bank duhet që të sigurojë që kërkesat e rregullatorit për mjaftueshmërinë e kapitalit janë plotësuar. Raiffeisen Bank mban shumë kapital se sa nevojitet nga kërkesa minimale e rregullatorit, si një shtesë të cilën mund ta përdori në rast të një risku të caktuar, në mënyrë që të mos jenë të nevojshme ndërhyrje nga rregullatori dhe për pasojë banka të përballet edhe me humbje reputacionale. Kjo është quajtur Kapaciteti i Rrezikut, e thënë ndryshe Kapitali Rregullator i cili është shuma e Kapitalit Bazë të nivelit të parë, Kapitalit Shtesë e nivelit të parë dhe Kapitali i nivelit të dytë. Niveli i kapitalit të mbajtur nga banka gjithashtu shërben edhe për rastet e rritjes së aktivitetit të biznesit në të ardhmen. Meqënëse Kapaciteti i Rrezikut bazohet kryesisht në pjesën e kapitalit mbi kërkesën minimale për kapital, është e nevojshme një përkufizim i kërkesës minimale për kapital për konceptin e Kapacitetit të rrezikut. Përgjithësisht, kërkesa minimale për kapital është kërkesa për kapital për "Shtyllën I" (risku i kredisë, risku i tregut dhe riskut operacional). Në mënyrë që të kemi nivel optimal të kapitalit të mbajtur, kur përcaktohet niveli i Kapacitetit të Rrezikut, aksionerët duhet të bëhen me dije se përveç nivelit minimal të kërkesës për kapital, banka mund të përballet me ngjarje të cilat mund të shkaktojnë risk të paparashikuar dhe /ose të pamatur. Këto risqe vlerësohen nën "Shtyllën II" të kërkesës për kapital të cilat konsistojnë në: rrezikun e përqendrimit të kredisë, rrezikun e mbetur, risqe që vijnë nga faktorë të ambientit të jashtëm (p.sh. Stress test) dhe risqe të shprehura si risqe të tjera, të cilat janë vlerësuar nëpërmjet procesit vjetor të vlerësimit të profilit të rrezikut të bankës. Duke qenë se luhatjet e mundshme në tregjet financiare dhe në situatën ekonomike dhe paparashikueshmëria e risqeve specifike të veçanta, niveli i oreksit ndaj rrezikut duhet të vendoset në një nivel më të ulët se sa ai i risk tolerancës, me një diferencë të tillë që të mund të evitohet, thyerje të mundshme të nivelit Kapacitetit të Rrezikut të buxhetuar. Niveli i oreksit ndaj rrezikut është përcaktuar të jetë sa 85 përqind e Kapacitetit të Rrezikut të buxhetuar. Risk Toleranca është përcaktuar të jetë në nivelin 95 përqind të Kapacitetit të Rrezikut të buxhetuar. Objektivat janë vendosur sipas projekt buxhetit dhe planit afat-mesëm të bankës, duke përfshirë edhe rezervat e caktuara në mënyrë që të mbulojnë luhatjet e mundshme të kushteve të tregut.

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun (në mijë EUR)	2020	2021	2022
Rreziku i Kredisë	813,648.35	878,475.77	951,295.61
Rreziku i Tregut	8,305.73	8,304.74	8,304.04
Rreziku Operacional	150,072.64	148,245.50	152,225.87

	Dhjetor 2019
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	19.34%
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas metodologjisë së PVBMK	18.16%

Raporti i Segmenteve

Segmenti Korporatë

Gjatë vitit 2019 segmenti i korporatave vijoi të forcojë pozicionin në tregun lokal. Portofoli i kredive shënoi një rritje prej 7,4 përqind krahasuar me vitin e mëparshëm. Si rezultat i rritjes së volumit të kredive dhe atyre të menaxhimit të likuiditetit, përfitueshmëria shënoi një rritje të konsiderueshme prej 15,7 përqind në krahasim me vitin 2018. Shumë iniciativa dhe fushata u paraqitën gjatë 2019 të cilat i dhanë një shtysë aktivitetit të kredidhënies duke shënuar rritje me 10 përqind në bazën e klientëve huamarrës.

Me qëllim përmirësimin e udhëtimit të klientit dhe rritjes së kënaqësisë së tyre, në marrjen e shërbimeve, gjatë 2019 u ndërmorën iniciativa të përbashkëta me departamente të tjera të bankës të cilat u fokusuan në përmirësimin e efikasitetit si: prezantimi i konceptit të përshtatjes së shpejtë të kredidhënies, që konsiston në një proces kredidhënie më të thjeshtë, procedura më të shpejta dhe të shkurtra administrative kredidhënie etj.

Cilësia e portofolit vijoi të ishte në rrugë të mbarë duke përmirësuar raportin e kredive jo performuese. Këto arritje u mundësuan si rezultat i qasjes pro aktive në menaxhimin e klientëve të këtij portofoli nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta dhe masave të ndërmarra nga stafi i bankës i përfshirë në proces.

Në vijim, bankingu me korporatat do të vijojë të ketë në fokus rritjen e kënaqësisë së klientit në shërbimet e ofruara duke rritur produktivitetin dhe të qenit një organizatë që përshtatet me nevojat e klientëve.

Prej shumë vitesh divizioni i korporatave vijon t'i shërbejë kategorive të mëposhtme të klientëve:

- Korporata vendas
- Korporata të huaja
- Institucione publike, njësi qendrore e vendore dhe organizata jo fitimprurëse

Në linjë me strategjinë e saj afatgjatë, Raiffeisen Bank Sh.a, ndikon pozitivisht në ekonominë Shqiptare nëpërmjet rritjes së standardeve në tregun bankar. Në këtë këndvështrim ka investuar vazhdimisht në një partneritet afatgjatë dhe marrëdhënie të konsoliduar me të gjitha Institucionet Publike të Qeverisë Qendrore dhe Lokale, duke luajtur rol thelbësor në mbështetjen e projekteve të ndryshme lidhur me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit nëpërmjet zgjidhjeve novatore dhe shërbimeve bankare të një standardi të lartë. Finalizimi i këtyre projekteve ka lehtësuar shkëmbimin e informacionit midis bankave dhe institucioneve të ndryshme publike, duke përmirësuar ndjeshëm standardin e shërbimeve të ofruara për publikun e gjerë. Kjo sinergji e ka vendosur Bankën Raiffeisen në pozicionin e partnerit kryesor të Qeverisë Shqiptare.

Biznesi i vogël (SE)

Biznesi SE ka reflektuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2019. Shfrytëzimi i mundësive të ofruara në treg dhe rritjes së përgjithshme të kërkesës nga këto shoqëri, ka bërë të mundur një rritje të përgjithshme të volumit të kredive me 11 përqind krahasuar me një vit më parë. Po kështu, volumi i transaksioneve të klientëve ka reflektuar rritje të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2019. Të dy këto faktorë kanë mundësuar që dhe pse në kushte operimi në një ambient me norma të ulëta dhe në rënie të interesave, fitimi operativ të shënojë rritje prej 17,5 përqind gjatë vitit 2019.

Qëllimi ynë është të jemi pranë shoqërive SE, të kuptojmë kërkesat e tyre dhe bazuar në profilin, madhësinë e aktivitetit, kompleksitetin e transaksioneve dhe kërkesave për financim, të sigurojmë zgjidhje të përshtatshme për klientët tanë. Për këtë, gama e produkteve dhe shërbimeve përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me specifikat e kërkuara nga shoqëri tregtare të ndryshme, ndërkohë që komunikimi dhe marrëdhënia e ngushtë me klientin mbetet tipari ynë dallues për të siguruar sukses.

Përveç rritjes të zgjeruar të degëve që zotëron Raiffeisen Bank Sh.a, shoqëritë SE mund të përfitojnë nga Platforma jonë Digjitale. Kjo platformë vijon të jetë avantazhi ynë kryesor, pasi ju siguron klientëve një eksperiencë të thjeshtë dhe të përshtatshme. Platforma Raiffeisen ON synon të përmirësojë eksperiencën e klientit dhe t'i sigurojë në çdo kohë dhe kudo mundësi shërbimi, ndërkohë që ofron dhe kosto më të ulëta transaksionesh. Raiffeisen ON ka mundur që të rrisim këtë volum transaksionesh vit pas viti, si dhe në këtë mënyrë të rrisim numrin e bazës së klientëve në bankë.

Objekti kryesor, në çdo rast mbetet rritja e volumit të biznesit, por duke ruajtur cilësinë e portofolit. Në këtë drejtim, ne kemi mundur të përmirësojmë raportet e kredive të këqija edhe gjatë vitit 2019. Kjo është arritur si rezultat i një përqaasjeje të kujdesshme dhe pro aktive gjatë menaxhimit të klientëve tanë, nëpërmjet përpjekjeve të bashkërenduara të të gjithë departamenteve të bankës.

Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE

Produktet e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër

Njësia e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër, ka vijuar edhe gjatë vitit 2019 të mbështesë klientët e saj Korporatë dhe SE në të gjitha çështjet që lidhen me realizimin e transaksioneve në fushën e Financave Tregtare dhe me përdorimin e produkteve të Financimit Afatshkurtër.

Përmes një stafi të specializuar kjo njësi ofron shërbimin e këshillimit ndaj klientëve të saj lidhur me njohjen dhe përdorimin e duhur të transaksioneve të Financave Tregtare si Garancitë Bankare, Letër Kreditë dhe Dokumentet për arkëtim. Banka zotëron ekspertizën e duhur teknike dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e klientëve në lidhje me mënyrën dhe avantazhet e përdorimit të Produkteve të Financave Tregtare dhe ka vijuar të kontribuojë në ndërgjegjësimin dhe rritjen e shkallës së përdorimit të këtyre produkteve nga klientët e segmentit Korporate dhe SE.

Puna e Njesisë së Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër ka ndihmuar klientët në drejtim të reduktimit të riskut në marrëdhëniet tregtare me partnerë ndërkombëtar dhe vendas si edhe në realizimin në kohë dhe me cilësi të transaksioneve të Letër Kredive (Import dhe Eksport), Garancive Bankare (direkte dhe indirekte), Letër Kredive 'Stand By' (dhe Dokumentet për Arkëtim (Import dhe Eksport).

Në bashkëpunim me forcën shitëse, gjatë vitit 2019 kjo njësi ka kontribuar në mbajtjen e një niveli të lartë të volumeve të realizuara në fushën e Financave Tregtare dhe ka vijuar të ruajë një nivel të lartë specializimi, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes trajnimit të rregullt të specialistëve, mbështetjes së bankës Raiffeisen Bank International AG, Vjenë, bashkëpunimit me bankat e rrjetit si dhe duke shfrytëzuar strukturat e saj të balancuara dhe rrjetin e gjerë të kanaleve të shpërndarjes. Njëkohësisht Raiffeisen Bank vijon të bashkëpunojë me një numër të konsiderueshëm bankash korrespondente, të shpërndara në të gjithë botën, të cilët veprojnë si partnerë dhe ndihmojnë për arritjen e një performace të suksesshme në realizimin e transaksioneve të Financave Tregtare.

Gjatë vitit 2019 Njësia e Produkteve të Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër, në bashkëpunim me forcën shitëse ka intensifikuar komunikimin me klientët e segmentit Korporatë të bankës për të rritur nivelin e tyre të njohurive për produktin e Faktoringut dhe avantazhet e përdorimit të tij si dhe për të nxitur këtë segment klientësh të konsiderojë produktin e Faktoringut si një mundësi alternative për financimin dhe menaxhimin më efektiv të nevojave të tyre afatshkurta për likuiditet.

Njësia e Financimit të Projekteve, Investimeve Afatgjata dhe Agrobiznesit

Në vlerësimin e nevojave të financimit dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve financiare për projekte afatgjata industriale, pasuri të paluajtshme dhe agrobiznesit, Njësia e Financimit të Projekteve, ka qenë dhe vazhdon të jetë e angazhuar jo vetëm për realizimin e tyre, por edhe zhvillimin më tej, me seriozitet dhe kompetencë profesionale.

Raiffeisen Bank Sh.a ka qenë dhe është në vazhdimësi e përqendruar në rritjen e bashkëpunimit me klientët e saj, të cilët gjejnë tek ajo një partner të denjë, për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve specifike, duke respektuar praktikat më të mira të tregut financiar, brenda dhe jashtë vendit. Raiffeisen Bank Sh.a, falë përvojës dhe aftësive profesionale të stafit, konstatuar gjatë bashkëpunimeve të saj, renditet si një partner i denjë me institucionet ndërkombëtare financiare, prandaj i është besuar një rol aktiv në financimet e strukturuar kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në fokusin e saj mbeten gjithmonë nevojat financiare të klientëve, për rrjedhojë njësia jonë ka qenë dhe mbetet e angazhuar në vlerësimin e aspektit teknik, ligjor, strukturës financiare të çdo projekti, si dhe monitorimit të performancës së tyre hap pas hapi, nga faza fillestare deri në përfundimin e tij.

Qëllimi i bankës sonë ka qenë dhe është jo vetëm partnere, por kërkon edhe të përfshihet në projekte vetë-likuiduese, me ndikim pozitiv në mjedis. Financimi i Hidrocentraleve dhe Agrobizneseve mbeten prioritet, bazuar në analiza të detajuara dhe cilësore, mbi të cilat kryhet vlerësimi shkencor i riskut, për të gjitha projektet me synim sigurimin e një portofoli cilësor në këto sektorë, që ndikon pozitivisht edhe në performancën e institucionit tonë.

Njësia e Financimit të Projekteve, Investimeve Afatgjata si dhe Agrobiznesit, gjatë vitit 2019 në bashkëpunim me disa aktorë si BERZH, IPARD-II, dhe forcës shitëse kanë pasur prioritet rritjen e nivelit njohjes të produkteve të reja agro që ofron Raiffeisen Bank, avantazhet dhe disavantazhet e këtyre financimeve, si dhe për të nxitur bizneset, për zhvillimin me sukses të veprimtarisë së agrobizneseve, performancës financiare, ruajtjes së mjedisit dhe sigurisë për likuiditet.

Ndjekja me rigozitet e përfundimit me sukses të çdo projekti dhe ofrimi i fleksibilitetit në financim, në përputhje me dinamikën e tregut, kanë qenë dhe janë cilësi kryesore të cilat e dallojnë Raiffeisen Bank si: kreativiteti, kompetencat si dhe njohja e mirë e tregut.

Produktet e Manaxhimit të Likuiditeteve

Fokusi kryesor ekipit gjatë këtij vitit ka qenë digjitalizimi i produkteve të Manaxhimit të Likuiditeteve dhe përmirësimi i kënaqësisë së klientit kundrejt Platformës sonë Digjitale Raiffeisen ON.

Platforma Dixhitale - Raiffeisen ON

Raiffeisen Bank ka vazhduar të investojë në teknologji për të qenë banka më e rekomanduar për shërbimet e bankingut digjital.

Gjatë vitit 2019 platformës iu shtuan funksionalitete të reja më novatore dhe proceset ekzistuese u përmirësuan dukshëm. Përmes përpjekjeve të përkushtuara dhe të vazhdueshme të menaxherëve tanë të produkteve, numri i klientëve të biznesit që përdorin platformën u rritën në mënyrë të dukshme.

Gjithashtu, një bashkëpunimi i gjerë midis forcës shitëse dhe njësisë së zhvillimit të biznesit solli një rezultat të suksesshëm duke përmbyshur nevojën e klientëve për një shërbim bankar të shpejtë dhe me cilësi të lartë.

Zhvillimi i Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Mesme

Objektivi kryesor i njësisë së zhvillimit të biznesit korporatë dhe bizneseve të mesme ka qenë koordinimi dhe ndjekja e procesit të ri të çeljes dhe monitorimit të klientëve për segmentin e biznesit Korporatë dhe të mesëm, sipas direktivës së 4-t Evropiane të AML-së. Duke qenë proces i ri, stafi i dedikuar në njësi sipas segmentit të biznesit është përpjekur për ta përcjellë këtë proces sa më lehtë dhe me profesionalizëm në marrëdhënie me klientët dhe në të njëjtën kohë kanë mbështetur forcën shitëse për çdo problematikë deri në zgjidhjen e tyre lidhur me këtë proces të ri.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e eficiencës së proceseve për korporatat dhe bizneset e vogla, është garantuar nëpërmjet automatizimit të proceseve dhe duke vendosur punonjës të përkushtuar për biznesin në degët kryesore të bankës.

Gjithashtu në kuadër të procedimit të shpejtë dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore, proceset e brendshme të bankës janë rishikuar për të qenë sa më të thjeshta dhe eficiente.

Gjithashtu, "zëri i klientit" është në vëmendje të vazhdueshme nga ana e bankës duke dëgjuar dhe administruar me përkushtim, çdo ankesë të mbërritur nga klientët. Ky proces ka një vlerë të shtuar, pasi jo vetëm ndihmon për t'i ofruar zgjidhje klientëve për problematikën e hasura por njëkohësisht ndihmon në përmirësimin e shërbimeve dhe proceseve të bankës në të ardhmen.

Retail Banking

Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

Segmenti i Klientëve Individë

Fokusi për segmentin individë vazhdon të jetë rritja e veprimtarisë bankare të klientëve, nxitja e marrëdhënieve primare dhe afrimi i klientëve të rinj, kryesisht të moshave të reja të popullatës.

Gjatë vitit 2019, baza e klientëve aktivë vazhdoi të jetë 83 përqind, ndërsa klientët primarë u rritën me 2,4 përqind nga viti në vit. Kemi pasur performancë shumë të mirë në duke e rritur bazën e klientëve të rinj me rreth 12 përqind në krahasim me vitin 2018.

Pavarësisht mjedisit tepër sfidues dhe konkurrues, ne kemi arritur të mbajmë në të njëjtat nivele bazën e klientëve paga marrës në të dy sektorët publik dhe privat, duke ruajtur pozicionin tonë lider në treg për të punësuarit e sektorit publik, ku aktualisht zotërojmë 48 përqind të tregut.

Gjatë vitit 2019 ne prezantuar një model të ri për paketat e produkteve dhe shërbimeve për klientët individë. Bashkimi i paketave të Ciklit të Jetës në një paketë të vetme, si edhe prezantimi i paketës së re 'Raiffeisen Digi' sjellin një koncept të thjeshtë, praktik, novator dhe në përputhje me misionin dhe strategjinë e digjitalizimit të bankës.

Paketa 'Raiffeisen Digi' është një paketë e përshtatur për klientët që janë të pasionuar pas teknologjisë, inovacionit dhe preferojnë më së shumti të përdorin kanalet digjitale.

Banka mori pjesë në projektin e Bashkisë Tiranë për Kartën Bashkiake të Studentit gjatë fazës së parë, e cila u zhvillua gjatë muajve qershor-korrik 2019, si banka e parë ekskluzive që ofron kushte preferenciale për paketën e shërbimeve për studentët. Përmes kësaj iniciative ne synojmë të rrisim blerjen e klientëve në fazat e hershme të bankingut dhe shndërrimin e tyre në klientë aktive / primarë.

Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë aktivitetin e klientëve tanë, të rrisim përdorimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, të përthithim grupe të reja të klientëve si të rinjtë dhe klientë me profil të digjitalizuar, të përmirësojmë modelin e paketave etj.

Si një bankë e sigurt dhe e besueshme ne do të mbështesim klientët tanë me shërbim të thjeshtë dhe të shkëlqyer në çdo bashkëveprim me bankën, nëpërmjet shërbimeve digjitale superiore për t'ju ofruar një eksperiencë bankare komode dhe pa stres.

Segmenti Premium

Banka Raiffeisen udhëheq tregun bankar në shërbim të avancuar të klientëve më të mirë që prej fillimit të segmentit Premium, në vitin 2010.

Aktualisht ne kemi afërsisht 11,100 klientë në segmentin Premium me kërkesa të ndryshme bankare, duke filluar nga kërkesat primare e deri tek ato më komplekse, të cilat kërkojnë këshillim të plotë financiar.

Janë dy nivele klientësh në segmentin Premium:

- klientët Premium Classic, të cilët marrin një shërbim të veçantë nga personel me shumë eksperiencë në degë dhe
- klientët Premium Club, me të ardhura tepër të larta dhe për të cilët kanali i shërbimit është më i veçantë dhe më i specializuar.

Klientët Premium Club shërbehen në zona private në degë nga Menaxherët e Dedikuar Premium.

Menaxherët e Dedikuar Premium janë të lokalizuar në 15 degë në qytetet më të mëdha të vendit, të cilët jo vetëm që ofrojnë një shërbim të personalizuar, por janë të trajnuar edhe në këshillimin financiar.

Strategjia e segmentit Premium është që të rritet më tepër në kredithënie dhe në transaksione, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave në bankë. Për vitin 2019, segmenti Premium u rrit në portofolin e aseteve me plus 11 përqind krahasuar me një vit më parë.

Banka jonë është e përkushtuar për të ofruar nivelet më të larta të menaxhimit dhe shërbimit të klientëve Premium.


Segmenti i Bizneseve Mikro

Raiffeisen Bank Sh.a gëzon tashmë një eksperiencë dhjetë vjeçare në biznesin mikro, duke ofruar një linjë të plotë shërbimesh profesionale për këtë segment. Ne jemi fokusuar në tërheqjen e klientëve të rinj nëpërmjet programeve të veçanta duke u ofruar klientëve mikro një linjë prej tre paketash shërbimesh përmes të cilave klientët mund të zgjedhin atë që i përshtatet më shumë nevojave të tyre.

Vlera që ne propozojmë është një kombinim i produkteve konkurruese dhe shërbimi të dedikuar, duke ofruar një partneritet solid dhe shërbim të dedikuar këshillimi mbi nevojat e menjëhershme ose të ardhme të bizneseve mikro, duke ruajtur gjithnjë standarde të larta të shërbimit. Nëpërmjet forcës sonë shitëse të dedikuar shërbimet bankare do t'u ofrohen klientëve të këtij segmenti në degët kryesore të shpërndara në qytetet më të mëdha në Shqipëri. Që nga prezantimi i platformës tonë digjitale Raiffeisen ON, banka është fokusuar në strategjinë e digjitalizimit, duke orientuar klientët e saj nga transaksionet në degë tek kanalet digjitale.

Viti 2019 rezultoi me përafërsisht 6,500 klientë të rinj, të cilët mundësuan rritjen e bazës sonë të klientëve në 28,800 klientë; portofoli i pasiveve kaloi 104 milion euro.

Volumet e pasiveve dhe numri i klientëve (Janar - Dhjetor 2019)



Për vitin 2020 projekti i ri-jetësimit të segmentit ka filluar dhe planet kryesore të punës përbëhen nga:

- Rishikimi i modelit të shitjes dhe shërbimit që reflekton gjithashtu rritjen e forcës së shitjes
- Rishikimi i paketave dhe propozimin e vlerës bazuar në nevojat e klientëve
- Rishikimi i huadhënies dhe përmirësimi i procesit të tij.
- Promovimi i sjelljes digjitale

Divizioni i Produkteve

Depozitat me Afat dhe Produktet e Kursimit

Gjatë vitit 2019 depozitat e klientëve individë vazhduan të zinin zërin kryesor në bilancin e bankës.

Normat e interesit në treg vijuan të shënojnë vlerat më të ulëta edhe gjatë vitit 2019, për shkak edhe të likuiditetit të tepërt në sistemin bankar. Si rrjedhojë, normat e interesit për depozitat me afat vijuan në nivelin më të ulët. Raiffeisen Bank ju ofron klientëve të saj mundësi alternative për mënyrën e menaxhimit dhe investimit të pasurisë, nëpërmjet shoqërisë bijë të saj Raiffeisen Invest, më e madhja shoqëri në Shqipëri e cila ofron mundësinë e investimit të fondeve për publikun. Pjesa më e madhe e klientëve tanë ka vijuar të besojë në bankën tonë duke i mbajtur depozitat e tyre

pranë nesh, pavarësisht normave të ulëta të interesit që ne ofrojmë. Një pjesë e mirë e klientëve tanë kanë zgjedhur të investojnë kursimet e tyre në fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, duke përfituar kështu të ardhura vjetore të mira, më të larta se depozitat me afat të ofruara në treg.

Fondet e Investimit të Raiffeisen Invest, të cilat ofrohen në të gjithë rritjen e degëve Raiffeisen, kanë tërhequr gjithashtu klientë të rinj si forma të reja investimi. Kombinimi i produkteve tradicionale të kursimit në Raiffeisen Bank me fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, i jep klientëve individë më tepër mundësi zgjedhjeje për të rritur të ardhurat e tyre.

Kreditë për Individë

Fokusi i bankës edhe gjatë vitit 2019 ka qenë në ofrimin e produkteve të kredive të përballeshme dhe fleksibël për klientët, sipas kërkesave të tyre. Raiffeisen Bank ka vijuar t'i kushtojë rëndësi të veçantë kredisë për individë duke rritur portofolin, duke synuar grupe të reja klientësh dhe duke promovuar avantazhet konkurruese, ndërkohë që tregu vazhdon të jetë nën ndikimin e normave të ulëta të interesit. Si rezultat, portofoli i kredisë u rrit në 286 milionë euro, duke mbajtur rekordin e rezultateve më të larta në 13 vite kredidhënie. Në këtë mënyrë, prania e Raiffeisen Bank në tregun bankar të kredidhënies për individë u rrit në 20 përqind të tregut.

Kreditë konsumatore ishin nxitësi kryesor i rritjes së portofolit të kredive për individë gjatë vitit 2019, pasi edhe kërkesa për këto lloj kredish në tregun shqiptar vazhdon të qëndrojë e lartë. Kërkesa e lartë, e shoqëruar nga fushata të ndryshme marketing gjatë gjithë vitit, kanë promovuar një varietet të gjerë normash fikse interesi dhe ka bërë që shitjet për kreditë konsumatore të rriten me 10 përqind nga viti në vit.

Gjithashtu, Raiffeisen Bank vazhdoi t'i kushtojë një vëmendje të veçantë kredive të siguruara, duke promovuar oferta konkurruese me interesa fikse gjatë vitit. Kredia për blerje shtëpie për "Familjet e reja", pjesë e programit të Bashkisë së Tiranës (faza e dytë) përfundoi me sukses, duke zgjeruar grupin e synuar për kreditë e siguruara dhe duke vazhduar bashkëpunimin e mirë me Bashkinë e Tiranës. Programe të ngjashme për kreditë e siguruara janë zgjeruar edhe në qytete të tjera kryesore në vend, për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve tanë. Këto programe rritën volumet e reja të disbursuara gjatë vitit 2019 me afërsisht 18 milion euro dhe përfaqësojnë afërsisht 55 përqind të disbursimeve të reja të kredive të siguruara gjatë vitit.

Në vitin 2019 gjithashtu u zgjodhëm si një nga tre bankat kryesore, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të fillojmë në vitin 2020 një program të ri për ofrimin e kredive të siguruara në të gjithë vendin për "Familjet e reja" me çmime preferenciale.

2020 pritet të jetë një tjetër vit i rëndësishëm dhe i suksesshëm për Raiffeisen Bank. Fokusi do të mbetet në ofrimin e përvojës më të mirë për klientët tanë, rritjen e portofolit të kredisë bazuar në nevojat ose kërkesat e klientëve, zgjerimin e programeve të kredisë së siguar, si dhe fushatave të ndryshme konkurruese. Si pjesë e rëndësishme e strategjisë së rritjes, Raiffeisen Bank do të eksplorojë gjithashtu mundësitë për të rritur ndjeshëm praninë e klientëve tanë dhe përvojën e tyre digjitale përmes kredidhënies.

Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik

Biznesi i Kartave

Në përputhje me strategjinë e saj të përgjithshme të digjitalizimit, Raiffeisen Bank Sh.a është përqendruar në digjitalizimin e eksperiencës së përdorimit të kartës së kreditit dhe debitit për klientët tanë.

Raiffeisen ishte banka e parë në tregun shqiptar që zhvilloi teknologjinë SmartPay, një mjet shumë novator për pagesa pa kontakt, i cili u prezantua në tremujorin e dytë të vitit 2019, duke u mundësuar klientëve tanë të përdorin me lehtësi një ministicker ose payband të pajisur me mikrocipin e kartës për të bërë pagesa pranë çdo tregtari të pajisur me një POS contactless (pa kontakt) pa pasur nevojë të mbajnë me vete portofolin e tyre.

Për këtë iniciativë të veçantë Raiffeisen Bank fitoi çmimin Mastercard si "Market Shaker" në Inovacionin për vitin 2019.

Rezultatet e vitit 2019 në biznesin e kartave konfirmojnë trendin pozitiv të rritjes së evidentuar në vitet e fundit. Numri

i klientëve të rinj për produktin e kartave të kreditit u rrit me mbi 11 përqind krahasuar me vitin 2018. Është më se e dukshme tashmë rritja e transaksioneve për pagesa të kryera nga klientët kartë mbajtës nëpërmjet Pikave të Shitjes POS (plus 16 përqind), duke reflektuar një trend të qëndrueshëm të rritjes së pagesave elektronike dhe uljes së transaksioneve të kryera me para në dorë (cash). Ky trend është kryesisht rezultat i fokusimit të bankës në rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin të klientëve në lidhje me përfitimet e përdorimit të kartave dhe përpjekjet në rritje nëpërmjet programeve të ndryshme gjatë vitit 2019, siç janë fushatat e shpërbimit për pagesa të kryera në POS, fushata promovuese e Eksperiencës "Disney Land Experience" etj.

Rezultate të konsiderueshme janë të pranishme edhe në portofolin e kartave të debitit. Numri i transaksioneve të kryera me kartat e debitit në ATM dhe терминаlet POS u rrit me 9 përqind me një rritje me të lartë për transaksionet e pagesave pranë pikave të shitjes me 57 përqind kundrejt vitit 2018. Karta e re e debitit pa kontakt (contactless) e prezantuar në mesin e vitit 2018 kontribuoi ndjeshëm në rritjen e totalit të transaksioneve në POS duke konfirmuar edhe një herë preferencën e fortë të tregut për teknologjinë novatore dhe mjetet e pagesave

Rrjeti i Pikave të Shitjes/POS

Raiffeisen Bank ka finalizuar me sukses strategjinë e optimizimit të POS-eve në biznesin e pranimit të pagesave me kartë, duke u përqendruar vazhdimisht në ofrimin e një shërbimi cilësor si dhe për të mbajtur pozicionin e liderit në treg. Për më tepër, Raiffeisen Bank është e përqendruar në zgjerimin e rrjetit POS-eve veçanërisht me një prani të fortë në kategorinë e tregtarëve potenciale siç janë qendrat tregtare, supermarketet, hotelet, pikat e karburantit, restoranteve, spitalet etj.

Rezultatet e vitit 2019 konfirmojnë suksesin e masave të zbatuara për të përmirësuar përfitueshmërinë e rrjetit të saj POS dhe kjo vërtetohet lehtësisht me rritjen prej plus 32 përqind të numrit të transaksioneve të kryera përmes këtij rrjeti. Për më tepër, harta e POS-eve u zgjerua me plus 29 përqind kundrejt 2018-ës.

Pranimi i pagesave me karta nëpërmjet Internetit / Shërbimi E-Commerce

Ne vijojmë të ofrojmë standardin më të përparuar të siguriës së pagesave për blerjet online të kryera nëpërmjet teknologjisë 3-D Secure. Raiffeisen Bank mbetet lider për shërbimin E-Commerce në tregun shqiptar. Një pozicionim i tillë konfirmohet lehtësisht përmes rritjes së numrit të transaksioneve për blerje online me 84 përqind krahasuar me vitin 2018 si dhe rënien e ndjeshme të numrit të reklamimeve për këto pagesa.

Rrjeti ATM

Raiffeisen Bank vazhdon të jetë lider në tregun shqiptar me rrjetin më të madh të ATM-ve. Rrjeti i ATM-ve vazhdimisht po optimizohet për t'i shërbyer më mirë nevojave të klientit, duke u fokusuar tek plotësimi i kërkesave të klientëve veçanërisht në zonat me trafik të lartë. Shërbimi në ATM mundësohet për të gjitha kartat e lëshuara globalisht nën markat VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus.

Funksionaliteti i depozitimit të parave në ATM, 'Cash-In', i prezantuar në mesin e vitit 2018, ka qenë një shërbim shumë i suksesshëm edhe përgjatë vitit 2019 duke shënuar një rritje të ndjeshme prej plus 138 përqind me shumë transaksione në krahasim me vitin e mëparshëm. Aktualisht ka 43 ATM në të gjithë vendin që u mundësojnë klientëve të depozitojnë 24/7 në llogaritë e tyre pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në degë.

Përmirësimi i funksionaliteteve digjitale të ATM-ve është pjesë e ekosistemit bankar shumë-kanalësh të Raiffeisen Bank që synon të rrisë disponueshmërinë dhe përdorimin e kanaleve bankare digjitale 24/7 në ATM-të dhe në Qendrat e Vetë-Shërbimit.

Bankingu dixhital

Raiffeisen Bank Sh.a i ka dhënë përparësi kryesore digjitalizimit dhe për të arritur këtë, ka hartuar një strategji ambicioze për të shndërruar përvojën bankare të klientit duke i ofruar një dimension shumë-kanalësh (omni-channel) digjital.

Ndërsa teknologjia po fiton rëndësi në çdo aspekt të jetës së klientëve tanë, Raiffeisen Bank ishte e para në treg që njohu urgjencën e menjëhershme për të digjitalizuar produktet dhe shërbimet e saj, me qëllimin për t'u ofruar klientëve të saj, shërbime me qasje të përshtatshme, duke i lejuar ata të veprojnë me lehtësi dhe pa probleme në platformën digjitale, pavarësisht se cilin kanal përdorin si kompjuter, laptop, celular, e deri te ATM dhe Terminalet e Vetë-Shërbimit.

Në vitin 2019, vëmendje e veçantë iu kushtua pagesave digjitale. Raiffeisen Bank erdhi me dy zgjidhje novatore të pagesave digjitale, KUIK (P2P) dhe Skano & Paguaj (P2B). KUIK u mundëson klientëve të transferojnë para menjëherë

tek miqtë e tyre falas, duke përdorur një numër celular që lidhet me një llogari rrjedhëse. Skano & Paguaj u mundëson klientëve të kryejnë pagesa të menjëhershme dhe të siguria nga llogaria e tyre direkt tek tregtarët që e ofrojnë këtë shërbim. Raiffeisen Bank është banka e parë në treg që prezanton këtë mënyrë të re pagese, duke siguruar përfitime të konsiderueshme për konsumatorët dhe tregtarët duke rritur në këtë mënyrë lehtësinë e pagesës jo-kesh, pa asnjë kosto apo shpenzime të fshehura nëpërmjet një procesi transparent.

Një arritje shumë e rëndësishme ishte edhe kalimi në një version të ri dhe të përmirësuar të platformës Digjitale Raiffeisen ON për klientët individë dhe mikro. Versioni i ri i Raiffeisen ON solli një dizajn krejtësisht të ri të aplikacioneve për telefonat celularë për përdoruesit dhe funksionalitete të reja të tilla, si hyrja me gjurmë gishti ose me fytyrë, KUIK - transferimi e parave menjëherë tek miqtë e tyre - nëpërmjet Raiffeisen ON.

Gjatë vitit 2019, numri i klientëve që u regjistruan në Raiffeisen ON u rrit me 34 përqind krahasuar me peshën në numrin e klientëve individë aktivë dhe me 48 përqind krahasuar me bizneset aktive mikro.

Pagesat

Platforma e re digjitale Raiffeisen ON ndikoi në rritjen prej 19 përqind të numrit të transfertave të kryera nga klientët individ, premium dhe mikro gjatë 2018. Transfertat e iniciuara nga kanalet elektronike arritën 67 përqind e totalit të transfertave, respektivisht 86 përqind individët dhe 43 përqind mikro. Të ardhurat nga komisionet e transfertave u rritën 14 përqind. Përmirësime të ndryshme janë aplikuar në procesin e transfertave në degë dhe zyrën qendrore.

Eksperienca e klientit

Duke pasur në vëmendje pritshmëritë e klientëve tanë në rritje dhe duke qenë pjesë e një tregu në ndryshim ku përqendrimi në digjitalizim është i lartë, 2019 ka qenë një vit sfidues për Raiffeisen Bank Shqipëri për t'ju përgjigjur pozitivisht kërkesave të klientëve me qëllim krijimin dhe ruajtjen e përvojave pozitive.

Raiffeisen Bank Shqipëri po punon vazhdimisht për të shndërruar konceptin e shërbimit ndaj klientit në përvojën e klientit në çdo pikë kontakti me bankën. Ne kemi mbledhur rregullisht zërin nga të paktën 20,000 klientë gjatë vitit përmes anketave të ndryshme, kryesisht të përqendruara për produktet e kredisë, ndërveprimet në ATM dhe platformën digjitale Raiffeisen ON, kënaqësia për trajtimin dhe zgjidhjeve të ankesave, por edhe nëpërmjet shërbimeve të tjera të identifikuar si momente të së vërtetës për klientët tanë. Fokusi ynë është të identifikojmë produktet dhe shërbimet që kanë nevojë për përmirësim duke siguruar për klientët tanë përvoja të shpejta, të thjeshta dhe cilësore përmes risive të vazhdueshme në të gjitha pikat e kontaktit me bankën.

Fuqizimi i kulturës së Përvojës së Klientit brenda organizatës, duke krijuar një sinergji të përbashkët të aktiviteteve dhe përmirësimeve që janë tashmë të dukshme, përfaqëson një qëllim të vazhdueshëm për ne. Më të rëndësishmet për tu përmendur janë vijueshmëria e trajnimeve "Fokusi te Klienti", iniciativa "Një Ditë në Degë" nga punonjësit e Zyrës Qendrore, duke përdorur historikun e klientit si një mjet për të krijuar produkte dhe shërbime sipas pritshmërive të tyre për klientët të cilët janë aktivë gjatë gjithë vitit.

Nëpërmjet nismave të ndryshme që ndërmerren gjatë vitit 'Ne vlerësojmë klientët tanë' synojmë të afrojmë punonjësit në degë me klientët e tyre, me komunitetin ku ata bashkëveprojnë çdo ditë dhe t'i tregojmë se ne kujdesemi për ta dhe shkojmë përtej veprimeve bankare.

Menaxhimi i marrëdhënies me klientin – CRM

CRM është një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të bankës dhe një kontribuues i rëndësishëm në përfitueshmërinë e tij. Ne përdorim të dhënat për të kuptuar klientët tanë dhe bazojmë vendimet tona mbi nevojat dhe kërkesat e tyre duke i zhvilluar më tej marrëdhëniet tona.

Ne po investojmë në zgjidhje për të bërë këtë proces sa më të shpejtë dhe natyral për klientët dhe punonjësit tanë. Ne zhvilluam CRM në degë ku tani punonjësit tanë mund të informohen për ofertat e klientit dhe mund t'ia komunikojnë ato me lehtësi. Kjo bën të mundur më shumë angazhim nga punonjësit dhe më shumë rezultate për bankën.

Projekti Multi-channel CRM po vazhdon me iniciativa të tjera për të përmirësuar lidhjen e klientit me bankën përmes përdorimit të të dhënave në mënyrë që ky ndërveprim të jetë sa më i personalizuar dhe i përshtatshëm për të. Këto iniciativa do të përmirësojnë eksperiencën e klientit dhe do të na bëjë të jemi banka më e rekomanduar prej tyre.

Qendra e Kontaktit

Qendra e Kontaktit të Raiffeisen Bank zhvillon aktivitetin e saj të fokusuar në dy drejtime kryesore:

- shqyrtimi i kërkesave të klientëve nëpërmjet telefonatave hyrëse dhe kanaleve të tjera alternative si email, mediat sociale dhe kanalet elektronike
- zhvillimi i fushatave telemarketing / informuese / pyetësorë për produktet dhe shërbimet e bankës

Agjentë në njësinë 'Incoming' – kërkesat hyrëse, ofrojnë shërbim 24 orë në 7 ditë, duke siguruar informacion mbi produktet dhe shërbimet e bankës, sipas nevojave të klientëve të identifikuar nëpërmjet telefonatave dhe kanaleve të tjera alternative të komunikimit. Kjo njësi ofron asistencë për shërbimet e kartave, veprimeve POS dhe E-commerce dhe kanaleve elektronike si Digital Banking dhe Kioskat e Vetëshërbimit.

Qendra e Kontaktit ka një rol shumë të rëndësishëm në aktivitetin monitorues për produktet e Kartave dhe Digital banking duke ndihmuar në parandalimin e rasteve të mashtrimit.

Gjithashtu, bazuar në strategjinë e CRM-së, agjentët e Telemarketing kontaktojnë klientët e përzgjedhur, nëpërmjet telefonit, SMS-ve dhe email-it për oferta të dedikuara që janë pjesë e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët e bankës. Gjatë vitit 2019 janë kryer rreth 160 fushata me një total prej 530,000 klientë të synuar ose rreth 30 përqind më shumë në krahasim me vitin 2018.

Gjithashtu në janar të vitit 2019 nga Raiffeisen Bank është prezantuar risia më e fundit në sistemin bankar, shërbimi i ChatBot i cili është një shërbim i automatizuar i ofruar në kanalet sociale Viber, Messenger, Telegram dhe së fundmi edhe në WhatsApp, për të cilin qendra e kontaktit ka një rol kyç në menaxhimin e shërbimit dhe asistencës në kohë të kërkesave të klientëve.

Fokusi ynë kryesor është zgjidhja në kohë e kërkesave të klientëve tanë, duke rritur cilësinë e shërbimit!

Kanalet e Shpërndarjes

Banka Raiffeisen është lider për sa i përket rrjetit më të madh të degëve në Shqipëri, me 76 degë të shpërndara në pjesën dërrmuese të qyteteve, konkretisht 44 qytete në të gjithë Shqipërinë. Rrjeti i degëve mbështetet nga 19 zona Vetëshërbim (SSC) të pajisura me 20 Terminale Financiare, që i janë bashkëngjitur degëve kryesore.

Gjatë vitit 2019, banka vazhdoi që të investojë në rrjetin e saj të degëve, me qëllim ruajtjen e standardeve të larta të shërbimit në të gjitha degët. Investime të konsiderueshme janë kryer në degët kryesore dhe me potencial, duke mundësuar hapësirë të përshtatshme në shërbim dhe me privatësinë e nevojshme për klientët.

Disa nga projektet për zhvillimin e rrjetit të degëve që janë përfunduar gjatë vitit 2019 janë:

- Një degë e rinovuar plotësisht sipas standardit të ri
- Një degë e zhvendosur në Tiranë
- Dy degë të ri-organizuar
- Dy zona të reja vetëshërbimi (SSC) pranë degëve ekzistuese, të pajisura me ATM Cash IN / Out dhe Terminal Financiare.

Këto projekte zhvillimore janë pjesë e strategjisë së bankës për digjitalizimin e modelit të bankingut. Ndërkohë, vazhdohet të investohet në rrjetin e degëve për të mundësuar një shërbim superior ballë për ballë me klientin, ku klientët mund të marrin këshillimin e duhur të ekspertëve dhe të diskutojnë nevojat e tyre bankare më të komplikuar.

Tërmeti që goditi Shqipërinë në muajin nëntor, ndikoi në mbylljen e përkohshme të katër degëve të përqendruara në rajonin e Durrësit dhe Tiranës. Këto degë janë në fazën e zhvendosjes, me qëllim që të hapemi për biznes, në kohën më të shkurtër të mundshme.

Gjatë vitit 2019, klientëve të bankës Raiffeisen ju mundësua kryeja e depozitimeve të parave pranë zyrave të Postës Shqiptare, në rastet kur përfituesi është një klient i bankës: qofshin këto individë apo biznese të vogla. Ky proces ka filluar në nëntë zyra të postës, në zona ku banka nuk është e pranishme dhe do të adresojë gjithashtu nevojat e vazhdueshme nga komunitete të ndryshme që kërkojnë prezencën e bankës në zonën e tyre nëpërmjet një dege bankare. Numri i zyrave postare mund të rritet në të ardhmen, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2020.

Ekipi i Efektivitetit të Forcës së Shitjes (SFE) udhëhoqi Strategjinë e Transformimit të Rrjetit të Degëve. Rregullimet e rrjetit përfshijnë: strukturat horizontale të raportimit, thjeshtëzim të roleve në degë, përgjegjësitë e shtuara për rolin shërbimit të klientëve, për sa i përket aktivitetit të shërbimeve jo-kesh si dhe shitjes së produkteve jo-kredi, forca shitëse e Mikros, që kalon nën përgjegjësinë direkte të degës.

Qëllimi kryesor i transformimit është rritja e aftësisë së rrjetit të degëve për të qenë më fleksibël dhe i gatshëm për t'u përshtatur me çdo ndryshim që mund të kalojë banka në vitet në vazhdim. Ky transformim do t'u mundësojë klientëve një shërbim "me një ndalesë – 'one-stop-shop'" për nevojat e tyre për transaksionet bankare ditore, duke optimizuar dhe përmirësuar kohën për shitje në degë; duke mundësuar që i gjithë stafi i degës të kontribuojë në përfitueshmërinë e degës; duke mundësuar një menaxhim të rezultateve, komunikimit dhe fokusit tek prioritetet e bankës.

Gjithashtu në 2019, 30 përqind e forcës sonë shitëse u trajnuar në Akademinë e Shitjeve. Modulet e trajnimit që u ndoqën përfshinin tema të tilla si: Inteligjenca Emocionale, Personaliteti, Aftësitë e Prezantimit, Standardet e Shitjes dhe Shërbimit në Raiffeisen Bank, Ekonomiksi i Sjelljes, etj. Qëllimi ynë është të ndihmojmë njerëzit të zhvillohen në mënyrë individuale dhe si pjesë e një grupi.

Banka Raiffeisen është banka më e madhe në vend që ofron shërbimin e financimit të shpejtë pranë disa dyqaneve, duke numëruar 24 pika shërbimi deri në fund të vitit 2019. Për herë të parë, po ofrohet shërbim i menjëhershëm për klientët tanë, duke mundësuar plotësimin e menjëhershëm të nevojave të tyre me një eksperiencë superiore shërbimi. Gjatë vitit 2020, do të shtohen dyqane të tjera dhe produkte të reja për klientët tanë, duke zgjeruar kështu përfitimet që ata do të marrin të kombinuara me standarde shumë të larta shërbimi.

Biznesi Mikro po vazhdon të rrisë bazën aktive të klientëve, duke ju afruar klientëve të rinj dhe atyre ekzistues një gamë më të gjerë produktesh dhe shërbimesh bankare. Qëllimi kryesor është, dhe do të vijojë të jetë, kalimi i transaksioneve bazike bankare në kanalet digjitale, duke çliruar kapacitetet e Menaxherëve të dedikuar të Marrëdhënieve me klientët që të fokusohen në marrëdhënie më cilësore me klientët dhe t'i shërbejnë edhe më mirë klientëve, duke qenë edhe me efektiv për sa i përket kostove. Raiffeisen Bank filloi aktivitetin strategjik për bizneset Mikro për sa i përket praktikave të on-boarding (familjarizimit të klientit me produktet dhe shërbimet e portofolit) dhe rritjes së mundësive të financimit nëpërmjet menaxherëve të dedikuar të marrëdhënieve me klientët dhe duke përmirësuar vlerën e propozuar si në aktivitetin e kredidhënies, ashtu edhe në shërbimet ditore.

Bankingu Premium vazhdon të jetë ofruer shërbimesh të cilësisë së lartë për klientët në vlera të larta, duke mundësuar që të gjitha nevojat e tyre, nga më baziket tek më të komplikuarat, të adresohen me një vëmendje me prioritet. Asnjë bankë tjetër në vend nuk ofron Bankingun Premium. Kjo i jep bankës Raiffeisen një avantazh të rëndësishëm konkurrues në tërheqjen, mbajtjen dhe rritjen e shërbimeve që përdoren nga klientët Premium.

Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të Ardhurat Fikse

Viti 2019 vijoi të ishte sfidues për njësinë tonë ndikuar nga shumë faktorë dhe rregullatorë lokalë, por kryesisht evropianë, ku ndikimi që kanë pasur të gjitha rregullat dhe standardet përkatëse lidhur me portofolin tonë kanë ndikuar në strategjinë e investimeve. Investimet tona në letra me vlerë të qeverisë janë bazuar edhe në strategjitë e ndjekura në nivel grupi duke qenë në përputhje dhe në ndikim të vazhdueshëm të kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian dhe institucioneve rregullatore të tij. Veçanërisht aktivet e konsideruara me risk të lartë, kanë ndikuar vazhdimisht edhe investimet tona. Pikësynimi ynë ka qenë mbajtja në nivel të caktuar të investimeve tona duke qenë në linjë jo vetëm me fitimin por sigurisht edhe me rregullatorët dhe institucionet vendase si dhe ato evropiane.

Struktura e portofolit ka vijuar të ndryshojë duke kaluar nga bonot apo investimet deri në një vit tek ato me fokus në bono afatmesme si obligacionet dy, tre vjeçare apo edhe ato pesë vjeçare pak më afatgjatë, ku këto dy të fundit kanë qenë pjesë e titujve reference, por gjithsesi ne zotërojmë një pjesë të investimeve në këto letra, pavarësisht se nuk jemi ende në panelin e bankave për këto tituj, me qëllim që të zhvillojmë sa më shumë tregun sekondar të letrave me vlerë, duke qenë pjesë aktive e tij.

Nga ana tjetër kemi ulur gjatë fundit të vitit 2019 investimet tona në obligacione të emetuara në Euro nga institucione ndërkombëtare financiare duke diversifikuar portofolin e tregut të parasë apo krijuar mjaftueshëm likuiditet afatshkurtër në Euro për të qenë edhe në përputhje me rregullat e reja për raportet e likuiditetit.

Viti që lamë pas pati një rënie të ndjeshme përgjatë tremujorit të parë të tij për sa i takon normave të interesit, por më pas ato u rikuperuan gjatë mesit të verës; gjithsesi kanë pasur luhatshmëri të vazhdueshme dhe tendencë në ulje për obligacionet tre dhe pesë vjeçare lidhur ngushtë me faktin e pranisë së likuiditetit në monedhën vendase dhe alternativat e investimit për këtë monedhë.

Edhe gjatë vitit 2019 kemi qenë mjaft aktiv në tregun sekondar veçanërisht në ankandet me të drejta të plota shitblerjeje, me bankat dhe institucione financiare vendase duke gjeneruar një fitim nga shitja relativisht të lartë dhe të kënaqshëm. Banka jonë vijoi të kryente aktivitetin e kujdestarit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke mundësuar investitorët e huaj dhe ata vendas të marrin pjesë në tregun tonë.

Tregu i Parasë

Njësia e Tregut të Parasë si një pjesë e rëndësishme e departamentit të thesarit në Dealing Room ka ndërmarrë një rol aktiv në arritjen e objektivit të menaxhimit të riskut për 2019, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të ndryshëm për mirëmbajtjen e Rezervës Minimale pranë Bankës Qendrore. Kjo njësi ka kontribuar vazhdimisht në mbajtjen në nivelet e duhura të koeficientit për administrimin e treguesit të likuiditetit sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Portofoli i Tregut të Parasë përgjatë gjithë vitit 2019 është mirë menaxhuar duke bërë një shpërndarje sipas maturimeve të ndryshme në përputhje me rregulloret në fuqi duke përbushur nevojat e Bankës dhe klientëve të saj për likuiditet në çdo moment dhe në çdo monedhë.

Kjo njësi ka dhënë kontributin e saj në menaxhimin e likuiditetit duke rritur ndjeshëm numrin e transaksioneve nder bankare, sidomos në atë vendas, duke e zhvilluar më tej aktivitetin ndër bankar duke përdorur instrumente të ndryshëm.

Pavarësisht kushteve në të cilat është gjendur tregu gjatë 2019, me interesat më minimale në historinë e tij, njësia e Tregut të Parasë ka dhënë kontributin e saj maksimal për një menaxhim të suksesshëm të likuiditetit duke arritur një performancë shumë të mirë.


Njësia e Tregut të Parasë prej vitesh është pjesë aktive e një tregu lokal në zhvillim duke kontribuar edhe në kuotimet

ditore për publikimin e TRIBID/TRIBOR. Këto kuotime janë një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të tregut duke pasqyruar aktivitetin e tij. Kjo njësi ka përditësuar vazhdimisht çmimet duke dhënë ndikimin e saj në zhvillimin e tregut si dhe gjetjes së mundësisë së vazhdueshme për financim me likuiditet në afatshkurtër.

Këto kuotime janë një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit të tregut lokal, pasi reflektojnë aktivitetin e saj, dhe TRIBID / TRIBOR janë gjithashtu një çështje e rëndësishme në parashikimin dhe interpretimin e situatës së likuiditetit të tregut.

Këmbimet Valutore

2019-ta ishte një vit shumë sfidues për euron ndërkohë që nëntë muajt e parë të vitit ishin shumë të mirë për dollarin Amerikan. Kishte disa luhataje por përgjithësisht trajektorja e indeksit të dollarit ishte e lartë. Vit shumë i mirë për dollarin Kanadez dhe paundin Britanik. Gjithë këto lëvizje janë ndikuar nga luftërat tregtare, ngadalësimi i ekonomisë globale, Brexit dhe lëvizjet rekord në stoqet amerikane si dhe nga politikat e ndryshme monetare të ndjekura nga FED dhe ECB. Ndërkohë në tregun vendas gjysma e parë e vitit ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme dhe luhataje të mëdha janë vënë re në gjysmën e dytë të vitit ku monedha evropiane humbi rreth tre pikë përkundrejt monedhës vendase Lekë.



Forcimi i Lekut është ndikuar nga një tepricë e likuiditetit në euro në tregun Shqiptar për rrjedhojë të investimeve të huaja dhe efektet e ofertë – kërkesës.

Për këtë arsye dhe për të rritur Rezervën Valutore Banka e Shqipërisë ka organizuar në mënyrë periodike ankande për blerjen e monedhës evropiane ku Raiffeisen Bank ka marrë pjesë në çdo ankand të organizuar.

Edhe pse një vit më shumë luhataje në tregun valutor vendas Njësia e Këmbimeve Valutore ka menaxhuar me kujdes pozicionin valutor dhe të gjitha rreziqet që lidhen me të. Kjo është arritur duke u bazuar në analiza profesionale të tregjeve financiare duke mbyllur vitin me rezultate shumë të mira.

Përgjatë vitit 2019 u rrit numri i transaksioneve të këmbimit të kryera nëpërmjet platformave digjitale si risi në tregun vendas.

Dollari Amerikan ka ndjekur të njëjtin trend si në tregun ndërkombëtar por më tepër është ndikuar nga teprica e likuiditetit në valutë në tregun vendas. Njësia e Këmbimit Valutor ka dhënë mbështetjen e saj maksimale në tregun lokal me mbajtjen e një kuotimi konkurrues në ofertë/kërkesën në tregun ndër bankar dhe me klientët.

Volumet e veprimeve të këmbimit valutor kanë vazhduar të jenë të larta veçanërisht në veprimet EUR/USD, në nivelet e 200 milionë euro në muaj.

Njësia e Shitjeve

2019 ka rezultuar një vit shumë i suksesshëm për sa i përket rritjes së numrit të veprimeve të këmbimit valutor si total dhe të numrit të veprimeve nëpërmjet platformës digjitale ku këto të fundit zënë rreth 60 përqind të veprimeve. Njësia e shitjeve të Thesarit vazhdon t'ju ofrojë klientëve produkte të Thesarit me norma shumë konkurruese duke mbyllur kështu vitin me një rezultat të lartë.

Në fokusin e tonë qëndron gjithmonë përmbushja e nevojave të klientëve në përputhje me politikat dhe strategjitë e bankës. Për këtë arsye vitet e fundit, klientët mund të përdorin produktet e thesarit 24/7 nëpërmjet platformave online dhe rezultatet janë shumë të kënaqshme.

Një rol kyç në arritjen e kësaj performance ka luajtur stafi i saj i dedikuar, profesional dhe bashkëpunues në të gjitha kanalet e biznesit të Raiffeisen Bank.

Departamenti i Shitjeve të Thesarit vazhdon të jetë lider në tregun financiar shqiptar duke ofruar çmimet më konkurruese në treg.

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Gjatë vitit 2019, Përgjegjësia Sociale e Korporatës ka vijuar të jetë në fokus të veçantë të veprimtarisë së Bankës Raiffeisen, duke dëshmuar edhe njëherë që përfaqësojmë një shoqëri që operojmë në mënyrë të qëndrueshme dhe etike. Ne mbajmë në konsideratë dhe i kushtojmë vëmendje zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit në të cilin veprojmë, zhvillimeve sociale dhe mjedisore si edhe respektimin e të drejtave të njeriut duke mbështetur projekte dhe praktika që synojnë në përmirësimin e jetesës dhe promovimin e një shoqërie të qëndrueshme.

Banka Raiffeisen edhe për këtë vit është një nga shoqëritë bankare me angazhimin më të madh në përgjegjësinë sociale të korporatës duke dhënë një ndikim të dallueshëm në shoqëri, në disa fusha veprimi me mbështetjet e dhëna në 98 projekte përgjatë vitit 2019.

Kjo veprimtari dëshmohej nga kontributi i dhënë në çështje sociale, si nisma e stafit të Bankës Raiffeisen, i cili nëpërmjet nismës "Raiffeisen për Shqipërinë" i erdhi në ndihmë familjeve të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit, ku dhuruam ushqime dhe ndihma të tjera të nevojshme për të kaluar situatën e vështirë.

"Karta e studentit" ishte një nismë tjetër në të cilin u angazhuam së bashku me Bashkinë Tiranë, duke ofruar një paketë shërbimesh bankare falas për të gjithë të rinjtë studentë me qëllim lehtësimin e integritit të tyre në shoqëri.

Më tej u mbështetën Fondacione të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë si për blerjen e materialeve shkollore ashtu edhe për aktivitete terapeutike, duke treguar vëmendjen që kemi ndaj zhvillimit të brezit të ri sidomos ndaj shtresave të margjinalizuara.

Një fokus të rëndësishëm i kemi dedikuar sektorit të shëndetësisë, si një prej sektorëve ku kontributi ynë është shumë i rëndësishëm dhe ndikimi është i matshëm. Vlejnë të përmenden rikonstruksioni i plotë i pavijonit të patologjisë në Spitalin Rajonal Berat, pajisja e Spitalit rajonal Krujë me një aparaturë "Echo" si dhe pajisja me aparatura të nevojshme laboratorike për Spitalin Rajonal Lezhë. Gjithashtu mundësuam rikonstruksionin e plotë të urës lidhëse në spitalin Rajonal Korçë si dhe rehabilitimin e plotë të fasadës së Spitalit Kolonjë.


Kontributi i Bankës Raiffeisen në fushën e arsimit ka qenë i konsiderueshëm dhe i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit duke mbështetur projekte arsimore për shkollat e mesme në vend ashtu edhe për universitetet. Këto projekte jo vetëm synojnë zhvillimin dhe përmirësimin e njohurive të nxënësve por ndihmojnë edhe në zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Një prej projekteve më të rëndësishme në këtë fushë kanë qenë pajisja e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës me një laborator të ri informatike si dhe rikonstruksioni i plotë i sallës së "Mediatekës" në Universitetin "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë. Gjithashtu edhe dy nisma në këtë kuadër për pajisjen me libra e dy të bibliotekave në dy shkolla në qytetin e Krujës dhe pajisja e një shkollë në qytetin e Lushnjës me laborator informatike. Projekti "Qyteti i Lexuesve", ishte një nismë tjetër e Raiffeisen Bank, i cili synon krijimin e hapësirave të reja letrare për edukimin e brezave të rinj që këtë vit u finalizua në qytetin e Beratit, pas bashkëpunimit të suksesshëm me bashkitë e qyteteve Tiranë, Lushnjë, Fier, Krujë dhe Divjakë duke bërë të mundur pasurimin e bibliotekave publike në këto qytete me shumë tituj librash të rinj.

Mbrojtja e mjedisit është gjithashtu një nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, (SGD) për të cilin Banka Raiffeisen ka dhënë kontribut të vyer që nga fillimet e saj. Prej më shumë se 11 vitesh, Banka Raiffeisen promovon dhe mbështet pastrimin e zonave bregdetare, duke organizuar fushata sensibilizimi lidhur me mbajtjen pastër të mjedisit ku nuk mungoi dhe kontributi vullnetari i stafit të bankës. Gjithashtu, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Bashkinë e Tiranës kemi mbështetur nismën e saj për pyllëzimin e Tiranës, duke bërë të mundur mbjelljen e 500 pemëve përgjatë rrugës dytësore në autostradën Tiranë Durrës. Më tej Raiffeisen Bank mbështeti Universitetin Bujqësor të Tiranës duke bërë të mundur rehabilitim e plotë të kopshtit botanik në këtë Universitet.

"Arti dhe Kultura" përfaqëson një tjetër fushë të rëndësishme për shoqërinë. Gjatë 2019 kemi mbështetur kalendarin artistik të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, Teatrit Kombëtar si dhe Teatrin e Kukullave. Gjithashtu janë mbështetur edhe shumë projekte të tjera kulturore jo vetëm në kryeqytet, por në të gjithë Shqipërinë. Vlejnë të përmenden Koncerti "Tre Tenorët", "Festivalit ndërkombëtar i të muzikës së Dhomës" në Durrës, festivali i Muzikës së Vjetër Baroke "Vox Baroque Albania" si dhe edicioni i 17-të i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit "Butrinti Summer Festival".

Projekte të tjera të rëndësishme që përkrahin turizmin dhe ndërgjegjësimin lokal ishin "South Outdoor Festival" si dhe Festivali Multikulturor në Berat, i cili promovon qytetin e bukur të Beratit si dhe traditën e zonave përreth.


Banka Raiffeisen në Shqipëri e konsideron shumë të rëndësishme Përgjegjësinë Sociale të Korporatës dhe me këtë fokus do të mbetet e përkushtuar për të dhënë kontributin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e kushteve sociale, shëndetësore dhe mjedisore të komunitetit në Shqipëri.

98 

Aktivitete të mbështetura

39 

Projekte me OJF

20 

Projekte Sociale

450 Njerëz në nevojë të ndihmuar



28 Projekte artistike & kulturore




65%

Projekte mbi parimet e Objektivave Globale (SDG) të Kombeve të Bashkuara për një botë më të mirë.



800 Pemë të mbjella



Burimet Njerëzore

Me një staf prej 1,300 punonjës, Raiffeisen Bank është një nga punëdhënësit më të fuqishëm dhe më të mirë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis konkurrues për sa i përket kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja

Gjatë vitit 2019, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në bankë, për të mbështetur nevojat e biznesit në të gjitha fushat ku vepron, me një total prej 167 punësime të reja.

Për të vlerësuar dhe përzgjedhur kandidatët më të mirë dhe profesionistët më të mirë në treg, ndiqet një proces rekrutimi i strukturuar prej disa fazash: testet teknike, logjike dhe/ose psikometrike si dhe testet e personalitetit. Kandidatët e përzgjedhur në këto faza bëhen pjesë e proceseve intervistuese, ku paneli është i përbërë nga supervisorët e departamentit/ menaxherët të distrikteve dhe përfaqësues nga Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Për Raiffeisen Bank fokusi kryesor mbetet promovimi dhe zhvillimi i punonjësve të saj. Kandidatët e brendshëm, në bazë të performancës së tyre, u konsideruan si potenciali kryesor për pozicionet e lira të shpallura në bankë. Për vitin 2019, 40 përqind e kandidatëve fitues për pozicionet e shpallura vakante kanë qenë punonjës të brendshëm. Kjo gjë krijon mundësi zhvillimi dhe ndërtimi të një karrierë të suksesshme brenda institucionit dhe rritjen e motivimit të brendshëm tek punonjësit.

Për të përmbushur nevojat për staf në pozicione të nivelit bazë, në rrjetin e degëve dhe disa departamente në zyrat qendrore, janë konsideruar me prioritet punonjës të punësuar nga shoqëri të jashtme, në një masë prej 45 përqind përzgjedhje në vendet vakante. Gjithashtu, studentët në Programin e Praktikës dhe studentët e programit DSA janë si burimi kryesor për plotësimin e këtyre pozicioneve.

Programi i Praktikës

Raiffeisen Bank ka krijuar traditën e saj të programit të praktikës. Synimi i saj është të tërheqë studentë me rezultate të larta, të cilët shfaqin një nivel të lartë motivimi, vullneti dhe dëshirë për të punuar në një mjedis financiar. Banka është e angazhuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe programi i praktikës është një element i rëndësishëm i saj. Në mirëpresim studentë nga universitetet me reputacion të lartë në të gjithë vendin, në mënyrë që ata të mësojnë në praktikë mënyrën se si funksionon Banka dhe t'i ndihmojë ata të përgatiten për tregun e punës.

Programi Studentët DSA

Programi i Studentëve DSA gjatë vitit 2019 ka konsoliduar bashkëpunimin midis bankës dhe shumë universiteteve në vend duke bërë pjesë 160 studentë pjesëmarrës. Fokusi i këtij programi, i nisur nga Departamenti i Shitjeve dhe Marrëdhënieve Direkte, është rritja e shitjeve të produkteve të ndryshme në degë. Studentëve të përzgjedhur, të cilët punojnë si Agjentë të Shitjeve Direkte, u ofrohet trajnim dhe mbështetje nga shitës me eksperiencë gjatë gjithë programit një vjeçar. Në fund të programit, ata fitojnë njohuri për produktet dhe proceset bankare dhe janë kandidatë potencialë për pozicionet e lira në bankë.

Programi i Studenteve DSA ka nxitur dhe shtuar biznesin në degë si dhe ka qenë një prurje shumë e mirë edhe në burime njerëzore për plotësimin e vendeve të lira.

Punonjës me kontratë të përkohshme nga shoqëri të jashtme

Gjatë vitit 2019 Raiffeisen Bank, ka vijuar bashkëpunimin me një shoqëri të jashtme, duke punësuar 143 punonjës me kontratë të përkohshme, sipas kërkesave të rrjetit të degëve dhe departamenteve në zyrat qendrore.

Këta punonjës marrin trajnime teorike dhe në punë (on job), për të përmbushur në mënyrë efikase kërkesat e pozicioneve përkatëse. Performuesit më të mirë inkurajohen për t'u bërë pjesë e procesit të rekrutimit për nevojat e bankës për staf të brendshëm.

Trajnimi

Raiffeisen Bank, përveç përfaqes së saj për të tërhequr dhe përzgjedhur punonjësit më të mirë në treg, është gjithashtu e angazhuar ndaj zhvillimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe njohurive të tyre. Programet e trajnimit dhe zhvillimit janë një investim strategjik për arritjen e objektivave të biznesit. Raiffeisen Bank ofron një Paketë Trajnimi për të gjithë punonjësit e rinj. Kjo paketë trajnimi është shumë e rëndësishme sepse u prezanton detyrat e reja që duhet të kryejnë dhe u mundëson një integrim sa më të lehtë në vendin e punës.

Për një grup të caktuar punonjësish të rinj (Punonjës të TI-së), është ndjekur një përfaqse e re, duke ofruar një paketë orientimi specifike (nëpërmjet Key Academy), për t'i mirëpritur ata në pozicionet konkrete të punës dhe për të pasur një mundësi qëndrimi sa më të gjatë në Bankë.

Ndërkohë, pas Paketës së Trajnimit për Punonjësit e Rinj, ose në rastet e ndryshimit të pozicioneve, ofrohen seanca trajnimi në vendin e punës (on job), nga punonjës me eksperiencë, të cilët shërbejnë edhe si mentorë të tyre.

Gjatë punësimit, punonjësve u ofrohen mundësi të mëdha për zhvillim dhe kualifikim. Banka ofroi një sërë programesh trajnimi dhe iniciativash të zhvillimit profesional, të cilat janë organizuar me lektorë nga burime të brendshme ose ekspertë të jashtëm. Në vitin 2019, plani vjetor i trajnimit reflektoi kërkesat e secilit departament për trajnime, që synojnë të rrisin apo të rifreskojnë njohuritë teknike ose kompetencat/afhtësitë që nevojiten për të përballuar sfidat dhe përmbushur rezultatet dhe objektivat e vendosura. Në këtë kuadër, janë zhvilluar **4,085.5 ditë trajnimi në klasë** me **100 përqind të stafit** që kanë ndjekur të paktën një ditë trajnimi.

Përveç trajnimit në klasë, stafit të bankës i është ofruar mundësia që të ndjekë trajnime elektronike në platformën e-learning ODA (Online Development Assistant), e cila shërben si mjet për menaxhimin e njohurive dhe informacionit me **1,328 ditë trajnimi në total**.

Frekuenca e përdorimit të kësaj platforme tregon interesin e gjerë në këtë metodë mësimdhënie, e cila ofron fleksibilitet, meqenëse modulet mund të ndiqen nga vendi i punës dhe në momentin kur dëshiron vetë punonjësi.

Divizioni i Burimeve Njerëzore mbështet objektivat afatgjata të biznesit duke u fokusuar në zbatimin e **Politikave të Menaxhimit të Talenteve dhe Planifikimit të Zhvillimit të Pasuesve**. Banka është e fokusuar në identifikimin e punonjësve të cilët demonstrojnë potencial të lartë për arritje dhe performancë konstante dhe zbaton plane për zhvillimin, ruajtjen dhe angazhimin e tyre.

Edukimi i Leadership-it dhe Menaxhimit është një tjetër fokus i Raiffeisen Bank. Programi i trajnimit për mendësinë Agile (E zhdërvjellët), i ofruar gjatë vitit 2019, synon të edukojë menaxherët e bankës mbi këtë mënyrë të re të të punuarit që po aplikon Banka.

Programet e rotacionit ishin një tjetër mjet zhvillimi, i ofruar për zhvillimin e stafit të Raiffeisen Bank. Këto programe u ofruan në nivel grupi dhe në nivel lokal. Objektivi i këtyre iniciativave është shkëmbimi i eksperiencave, njohurive dhe praktikave më të mira duke kryer vizita tek kolegët në departamente të tjera, brenda dhe jashtë banke.

Politika e shpërblimit të Grupit Bankar

Politikat e shpërblimit të Grupit Bankar hartohen nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe aprovohen nga Drejtoria dhe Këshilli Drejtues. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në rastin e përcaktimit dhe miratimit të elementit variabël (bonus) për punonjësit e Raiffeisen Leasing, ku struktura përgjegjëse për përcaktimin dhe aprovimin e tij është Këshilli Drejtues i Raiffeisen Leasing.

Fokusi i politikës së shpërblimit është plotësimi i standardeve ndërkombëtare me qëllim krijimin e një strukture kompensimi të drejtë dhe transparente sipas kërkesave aktuale të enteve rregullatorë. Politika e shpërblimit e Grupit Bankar është e qëndrueshme dhe nxit frymën e menaxhimit të një risku efektiv duke mos inkurajuar tejkalimin e niveleve të përcaktuara. Kjo politikë është në të njëjtën linjë me strategjinë e biznesit, objektivave, vlerave dhe interesave afat-gjatë të grupit RBI dhe të Grupit Bankar në Shqipëri.

Raiffeisen Bank Sh.a (përjashtohet Raiffeisen Leasing) çdo vit identifikon funksionet/punonjësit me ndikim material në profilin e riskut të bankës. Këta punonjës përcaktohen si "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) dhe procesi i tyre përzgjedhës bazohet në kërkesat/direktivat e grupit. Kategoritë e "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) janë si më poshtë:

- 1. Material ose "Staf i Identifikuar"** (Identified Staff) me ndikim të plotë. Kjo kategori ka një ndikim material direkt në profilin e riskut të bankës, sepse niveli i riskut i cili mund të jetë individual ose në grup, mund të ketë një ndikim thelbësor në rezultatet dhe pasqyrat financiare të bankës. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 35 dhe përfshin Anëtarët e Këshillit Drejtues, anëtarët e Drejtorisë, anëtarët e Komitetit të Auditit si dhe disa Drejtues të nivelit të mesëm.
- 2. Pjesërisht Material ose "Staf i Identifikuar"** (Identified Staff) me ndikim jo të plotë. Kjo kategori ka një ndikim në profilin e riskut të bankës, por jo domosdoshmërisht në një mënyrë të drejtpërdrejtë. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 44 dhe përfshin disa Drejtues të nivelit të mesëm.

Paga dhe përfitimet e tjera mbi pagën, përcaktohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë nivele të kënaqshme dhe konkurruese. Politika e ndjekur në përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave duhet të realizojë dhe garantojë arritjen e pesë objektivave kryesore:

- Shpërblimi për performancën dhe cilësinë e punës.
- Ruajtjen e një pozicioni konkurrues në treg. Kompensimi i përgjithshëm duhet të jetë në kuadratin (quartile) e tretë të tregut lokal (midis 50 dhe 75 përqind).
- Motivimin e punonjësve nëpërmjet shpërblimit (pagës) të diferencuar për përgjegjësi, pozicione pune dhe aftësi profesionale.
- Përfitimet shtesë duhet të jenë konkurruese, por jo kryesuese në treg.
- Shpenzimet për pagat në totalin e kostos së personelit dhe buxhetit në tërësi, të jenë në parametra të pranueshëm.

Për një kategori të caktuar pozicionesh, paga është e përbërë nga dy elemente:

- Paga bazë
- Paga variabël

Struktura e pagës bazë

- Përfaqëson të ardhurat bruto, duke përfshirë bonuset dhe përfitimet e tjera shtesë;
- Administrohen në bazë të niveleve të pagës, të cilat bazohen në strukturën e gradës, nivelin e jetesës në vend dhe të dhënat e tregut;
- Rritja e pagave është e lidhur ngushtë me rezultatin e performancës individuale. Kjo do të thotë që çdo punonjësi i lind e drejta për të përfituar rritje page kur niveli i performancës individuale është mbi 3.5 (vlera maksimale është 5). Përqindja e rritjes së pagës nuk do të jetë më e lartë se 25 përqind e pagës bruto.

Paga Variabël (Bonusi i Përgjithshëm / Bonusi Vjetor)

Paguhet apo përfitohet vetëm nëse plotësohen të gjitha kriteret rregullatore pranuese, të parashikuara në Politikën e Shpërblimit.

- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës së Grupit RBI (1/3); Bankës (2/3); Individit (mbi 3.5);
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin e shpërblimit të performancës së lartë;
- Nuk do të jetë më e lartë se: 16 përqind e pagës bazë vjetore për të gjitha pozicionet që janë të përfshira në bonusin vjetor;
- Nëse Paga/Elementi Variabël në terma vjetore tejkalon nivelin e 30,000 Euro, për kategorinë "Identified Staff" do të aplikohet një skemë e ndryshme pagese.

Në rastet e një performace financiare negative, bonusi vjetor mund të reduktohet apo anulohet.

Paga Variabël (Skemat Nxitëse me Risk të ulët)

- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës së Individit (mbi 70 përqind realizim objektiv);
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin e shpërblimit të performancës së lartë.
- Nuk do të jetë më e lartë se: 39 përqind e pagës bazë 3-mujore për të gjitha pozicionet që janë të përfshira në skemat nxitëse (shitëse dhe mbështetëse)

Tabelë 19:** Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues (çdo fund viti)
(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2019	Për periudha të kaluara Viti 2018
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	11,205	10,000
Cash/bonus	11,205	10,000
Aksione		
Të tjera		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		


** Kjo tabelë do të plotësohet më vete për **a)** Këshillin Drejtues dhe **b)** drejtuesit ekzekutivë.

Tabelë 19:** Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit ekzekutivë (çdo fund viti)
(shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2019	Për periudha të kaluara Viti 2018
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	225,080	230,436
Cash/bonus	195,592	197,946
Aksione		
Të tjera	29,488	32,490
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit	29,303	36,825
Cash/bonus	29,303	36,332
Aksione	0	493
Të tjera	0	0

** Kjo tabelë do të plotësohet më vete për **a)** Këshillin Drejtues dhe **b)** drejtuesit ekzekutivë.


Komitetet Drejtuese



Struktura organizative e bankës siguron një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjësi dhe raportimit, sipas modelit të tre linjave të kontrollit:

- i. Linja e pare e frontit (Biznesi)
- ii. Risku Operacional, Funkionet e Përputhshmërisë, Kontrolllet financiare, Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, etj.
- iii. Auditi i Brendshëm

të Raiffeisen Bank



Struktura e Riskut është e pavarur nga linjat e biznesit dhe njësite e tjera të brendshme që kontrollojnë. Struktura e Përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe njësite e tjera të brendshme që kontrollojnë.

Raiffeisen Bank sh.a. vepron në përputhje me parimet bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv sipas kërkesave të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre".

Përmbajtje

Raiffeisen Bank Sh.a.
Pasqyrat financiare të konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(me raportin e audituesve të pavarur)

Raporti i audituesve të pavarur	40
Grupi	42
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse	43
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	44
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	45
Pasqyra e konsoliduar e flukseve të mjeteve monetare	46
Shënime	47
Shënime për instrumentet financiare	63
Administrimi i rrezikut	80
Informacione të tjera	100
Informacion për autoritetin mbikëqyrës	102
Parimet e njohjes dhe matjes	103
Ngjarje pas datës së raportimit	119
Deklarata e përfaqësuesve ligjorë	120

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionerin dhe Bordin Drejtues të Raiffeisen Bank Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Raiffeisen Bank Sh.a' (më tej referuar si "Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2019 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionalistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u audituan nga një auditues tjetër, i cili shprehu një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare të konsoliduara më datë 5 korrik 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Konsoliduara

Toka dhe ndërtesa të tjera (investime në prona)	-32,048	-	-7,114	107,623
Mobiljet e zyrës, pajisjet dhe mjetet e tjera fikse materiale	-2,724,614	337,971	-216,483	774,677
E drejta e përdorimit të aseteve (RoU)	-	3,316	-274,808	1,225,782
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-1,676,250	89,010	-206,613	1,305,455
Programe dhe licenca	-1,676,250	89,010	-206,613	1,305,455
Totali	-5,151,507	442,330	-758,953	3,994,089

13. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA (VAZHDIM)

në mijë LEK	Kostoja e blerjes				Më 31/12/2018
	Në 1/1/2018	Shtesa	Pakesime	Transferime	
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	4,907,652	310,803	-286,880	-	4,931,575
Toka dhe ndërtesat që përdoren nga Grupi për qëllimet e veta	1,352,858	63,073	-98,463	477	1,317,945
Toka dhe ndërtesa të tjera (aktive afatgjata materiale për investim)	146,296	5,240	-4,751	-	146,785
Mobiljet e zyrës, pajisjet dhe mjetet e tjera fikse materiale	3,408,498	242,490	-183,666	-477	3,466,845
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	2,891,324	126,155	-4,942	-	3,012,537
Programe dhe licenca	2,891,324	126,155	-4,942	-	3,012,537
Totali	7,798,976	436,958	-291,822	-	7,944,112

në mijë LEK	Amortizimet dhe zhvleresimet			Vlera kontabël më 31/12/2018
	I akumuluar	Amortizimi i akumuluar për aktivet e shitura	Shpenzimi i vitit	
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-3,425,068	233,345	-283,534	1,456,318
Toka dhe ndërtesat që përdoren nga Grupi për qëllimet e veta	-713,200	59,497	-64,892	599,350
Toka dhe ndërtesa të tjera (investime në prona)	-26,369	2,765	-8,444	114,737
Mobiljet e zyrës, pajisjet dhe mjetet e tjera fikse materiale	-2,685,499	171,083	-210,198	742,231
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-1,430,373	3,706	-249,583	1,336,287
Programe dhe licenca	-1,430,373	3,706	-249,583	1,336,287
Totali	-4,855,441	237,051	-533,117	2,792,605

14. AKTIVE TATIMORE

në mijë LEK	2019	2018
Aktive tatimore aktuale	480,533	677,936
Aktive tatimore të shtyra	-	7,041
Totali	480,533	684,977

Aktivitet tatimore të shtyra rrjedhin nga zerat e mëposhtëm:

në mijë LEK	2018	Të njohura në fitim ose humbje	2019
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	7,041	-11,762	-4,721
Totali	7,041		-4,721

14. AKTIVE TATIMORE (VAZHDIM)

në mijë LEK	2017	Të njohura në fitim ose humbje	2018
Aktivët të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	20,140	-13,099	7,041
Totali	20,140		7,041

15. AKTIVE TË TJERA

në mijë LEK	2019	2018
Parapagimet dhe të ardhura të shtyra	278,902	285,727
Kolaterale të riposeduara, neto	1,344,113	1,359,633
Aktive të tjera	592,442	459,731
Totali	2,215,457	2,105,091

Kolaterale të riposeduara përfaqësojnë pasuri të patundshme të perfituara nga Grupi për shlyerjen e kredive të papaguara. Grupi pret të shesë kolaterale në të ardhmen të afert. Kolaterale nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje dhe klasifikohen si inventarë në përputhje me SNK 2 "Inventarët". Kolaterale fillimisht njihen me vlerën e drejtë kur janë perfituar.

Kolaterali i riposeduar, neto, përbëhet nga:

në mijë LEK	2019	2018
Kolaterale të riposeduara	1,876,047	1,780,254
Zhvlerësimi kolateralit të riposeduar	-531,934	-420,621
Totali	1,344,113	1,359,633

Lëvizjet në zhvlerësimin e kolateraleve të riposeduara janë si më poshtë:

në mijë LEK	2019	2018
Balanca në fillim të vitit	420,621	271,398
Shtesa në zhvlerësim	138,352	154,308
Rimarrje e zhvlerësimit	-27,039	-5,085
Balanca në fund të vitit	531,934	420,621

16. DETYRIMET FINANCIARE – ME KOSTO TË AMORTIZUAR

Tabela në vijim paraqet ndarjen e depozitave nga bankat dhe klientët sipas produktit dhe një pasqyrim të letrave me vlerë të lëshuara:

në mijë LEK	2019	2018
Detyrime ndaj bankave	4,791,034	6,452,671
Llogari rrjedhëse / depozita njëditore / të shlyeshme me njoftim	20,543	50,751
Depozitat me afat maturimi	2,896,002	4,502,291
Borxhi i varur	1,874,489	1,899,629
Depozitat nga klientët	188,121,303	187,798,423
Llogari rrjedhëse / depozita njëditore / të shlyeshme me njoftim	141,802,775	138,058,897
Depozitat me afat maturimi	46,318,528	49,739,526
Detyrime të tjera financiare	18,920	298,423
Qiramarrësi i detyrimeve të qirasë:	1,220,555	-
Totali	194,151,811	194,549,517

16. DETYRIMET FINANCIARE – ME KOSTO TË AMORTIZUAR (VAZHDIM)

Në depozitat nga Bankat është përfshirë borxhi i varur.

Gjatë vitit 2015, Raiffeisen International AG i dha Bankës një borxh të varur prej 15,000 mijë eurosh. Borxhi mbart një normë interesi prej 4.8% p.a. (2018: 4.8% p.a.) dhe maturohet në 28 qershor 2020. Borxhi renditet pas gjithë kreditorëve të tjerë në rast të likuidimit.

Tabela në vijim tregon efektet monetare dhe jo monetare për borxhin e varur sipas SNK 7:

në mijë LEK	2019	2018
Vlera kontabël më 1 janar	1,899,629	8,820,852
Fluksi i parasë		
Efekt ndryshimeve të kursit të këmbimit	-31,007	-146,682
Shpenzimet e interesit	94,516	337,406
Interesi i paguar	-88,649	-468,180
Principali i paguar	-	-6,643,768
Ndryshimi total	-25,140	-6,921,224
Vlera kontabël më 31 dhjetor	1,874,489	1,899,629

Tabela në vijim paraqet ndarjen e balancave me bankat dhe klientët sipas segmenteve të biznesit dhe borxhit të varur:

në mijë LEK	2019	2018
Banka qendrore	-	2
Institucione qeveritare	3,959,611	2,153,744
Bankat	4,791,034	6,452,669
Korporata të tjera financiare	3,636,469	3,507,756
Korporata jo-financiare	29,196,164	38,451,903
Individët	151,329,059	143,685,020
Totali	192,912,337	194,251,094

17. PROVIZIONE PËR DETYRIMET

në mijë LEK	2019	2018
Provizione për zërat jashtë bilancit	81,898	81,821
Provizione për detyrimet dhe angazhimet jashtë bilanci	81,898	81,821
Shpenzime të përlogaritura për stafin	179,725	174,889
Pagesa bonusi	134,959	125,428
Pushimet e pa marra	44,766	49,461
Provizione të tjera	27,747	36,071
Çështje ligjore dhe tatimore	27,647	36,071
Provizione të tjera	100	-
Totali	289,370	292,781

Tabela në vijim tregon ndryshimet në provizionet për detyrimet dhe pagesat në vitin raportues, ku nuk përfshihen rezerva për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9 prej 81,988 mijë LEK, të cilat janë paraqitur në shenimin (26) Zhvillimi i provizioneve.

17. PROVIZONE PËR DETYRIMET (VAZHDIM)

në mijë LEK	1/1/2019	Alokimet	Rimarjet	Përdorimet	Diferencat e këmbimit	31/12/2019
Shpenzime te perlllogaritura për stafin	174,889	118,778	-45,181	-68,761	-	179,725
Pagesa bonusi	125,428	88,778	-10,486	-68,761	-	134,959
Pushimet e pamarrë	49,461	30,000	-34,695	0	-	44,766
Provizione të tjera	36,071	669	-8,010	-983	-	27,747
Çështje ligjore dhe tatimore	36,071	569	-8,010	-983	-	27,647
Provizione të tjera	0	100	0	0	-	100
Totali	210,960	119,447	-53,191	-69,744	-	207,472

Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet në provigjonet e vitit të kaluar, ku nuk përfshihen rezerva për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9 prej 81,988 mijë LEK.

në mijë LEK	1/1/2018	Alokimet	Rimarjet	Përdorimet	Diferencat e këmbimit	31/12/2018
Shpenzime te perlllogaritura për stafin	160,548	338,759	-260,283	-64,135	-	174,889
Pagesa bonusi	120,548	292,395	-223,380	-64,135	-	125,428
Pushimet e pamarrë	40,000	46,364	-36,903	0	-	49,461
Provizione të tjera	43,020	14,710	-6,328	-14,631	-700	36,071
Çështje ligjore dhe tatimore	33,255	14,228	-6,328	-5,084	-	36,071
Provizione të tjera	9,765	482	-	-9,547	-700	-
Totali	203,568	353,469	-266,611	-78,766	-700	210,960

18. DETYRIME TË TJERA

në mijë LEK	2019	2018
Të ardhurat e shtyra dhe shpenzimet e përlllogaritura	188,060	242,581
Detyrime ndaj punonjësve	109,229	115,488
Detyrime të tjera tatimore	68,654	107,016
Detyrime të ndryshme	262,428	257,557
Totali	628,371	722,642

19. KAPITALI AKSIONAR

në mijë LEK	2019	2018
Kapitali aksionar	14,178,593	14,178,593
Rezerva të tjera	3,306,190	3,306,190
Fitimet e pashpërndara	11,268,568	10,129,883
<i>nga të cilat, fitimi për vitin</i>	<i>3,106,817</i>	<i>3,297,780</i>
Totali	28,753,351	27,614,666

Gjatë vitit 2019, mbledhja e Asamblesë së aksionerit të vetëm miratoi shpërndarjen dhe pagesën e dividendëve prej 1,964,211 Lekë nga fitimet e pashpërndara.

Zhvillimi i kapitalit paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit.

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i Grupit është 100,397,823 Euro i përbërë nga 7,000 aksione (2018: 7,000 aksione). Kapitali i Grupit është 14,178,593 mijë Lek dhe vlera nominale e çdo aksioni është 2,025,513 Lekë (2018: 14,178,593 mijë Lekë e përbërë nga 7,000 aksione me vlerë nominale prej 2,025,513 Lekë secila). Konvertimi i kapitalit u miratua me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit të datës 25 janar 2016.

Rezerva të tjera

Rezerva ligjore përcaktohet nga shpërndarja e fitimit neto pas tatimit në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare".

Rezerva rregullatore përcaktohet në përputhje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 69, datë 18 dhjetor 2014.

në mijë LEK	2019	2018
Rezerva rregullatore	1,852,979	1,852,979
Rezervat ligjore	1,453,211	1,453,211
Totali	3,306,190	3,306,190

SHËNIME PËR INSTRUMENTET FINANCIARE

20. VLERA E DREJTË E INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Matja e vlerës së drejtë në Grup bazohet në burimet e jashtme të të dhënave. Instrumentet financiare të matura në bazë të çmimeve të kuotuar të tregut janë kryesisht letra me vlerë të listuara. Këto instrumente financiare janë caktuar në Nivelin I të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Nëse përdoret një vlerë e tregut dhe tregu nuk mund të konsiderohet të jetë një treg aktiv në funksion të likuiditetit të kufizuar, instrumenti financiar themelor i caktohet Nivelit II të hierarkisë së vlerës së drejtë. Nëse nuk janë në dispozicion çmime të tregut, modelet e vlerësimit të bazuara në të dhënat e tregut të vëzhgueshme përdoren për matjen e këtyre instrumenteve financiare. Këto të dhëna të vëzhgueshme të tregut janë kryesisht përsëritja e kurbës së kthimeve, përhapja dhe luhatshmëria e kreditit.

Nëse vlera e drejtë nuk mund të matet duke përdorur çmime mjaft të rregullta të tregut (Niveli I) ose duke përdorur modele vlerësimi të bazuara tërësisht në çmimet e tregut të vëzhgueshëm (Niveli II), atëherë parametrat individuale të inputeve të cilat nuk janë të vëzhgueshme në treg vlerësohen duke përdorur supozime të përshtatshme. Nëse parametrat që nuk janë të vëzhgueshëm në treg kanë një ndikim të rëndësishëm në matjen e instrumentit financiar themelor, ajo i caktohet Nivelit III i hierarkisë së vlerës së drejtë. Këto parametra matjeje, të cilat nuk janë të vëzhgueshme rregullisht, janë kryesisht përhapjet e kreditit të nxjerra nga vlerësimet e brendshme.

Caktimi i instrumenteve të caktuara financiare në kategoritë e nivelit kërkon vlerësim të rregullt, veçanërisht nëse matja bazohet në të dy parametrat e vëzhgueshëm dhe gjithashtu në parametrat që nuk janë të dukshëm në treg. Klasifikimi i një instrumenti mund gjithashtu të ndryshojë me kalimin e kohës për të marrë parasysh ndryshimet në likuiditetin e tregut dhe kështu transparencën e çmimeve.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të raportuara me vlerën e drejtë

Në tabelat e mëposhtme, instrumentet financiare të raportuara me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë grupuar sipas zërave në pasqyrën e pozicionit financiar dhe klasifikohen sipas kategorive të matjes. Një dallim është bërë nëse matja bazohet në çmimet e kuotuar të tregut (Niveli I), ose nëse modelet e vlerësimit bazohen në të dhënat e tregut të vëzhgueshme (Niveli II) ose në parametrat që nuk janë të dukshëm në treg (Niveli III). Zërat janë caktuar në nivele në fund të periudhës raportuese.

Aktivet	2019			2018		
	Niveli I	Niveli II	Niveli III	Niveli I	Niveli II	Niveli III
Në mijë Lek						
Aktivet financiare - vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes			3133			2,516
Letrat me vlerë të borxhit			3133			2,516

Informacion cilësor për vlerësimin e instrumenteve financiare në Nivelin III

Aktivet 2019	Vlera e drejtë në mijë LEK	Teknika e vlerësimit	Te dhena të rëndësishme jo të vëzhgueshme	Diapazoni i të dhënave jo të vëzhgueshme
Aktivet financiare - vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		-		
Bonot e thesarit, obligacione me kupone fikse	3,133	Metoda e skontimit së flukseve të parasë (SFP)	Normat bazë të LEK- yllidet e ankandeve –B.Thesari	1.12 % - 1.61 %
Totali				

20. VLERA E DREJTË E INSTRUMENTEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk janë raportuar me vlerën e drejtë

Instrumentet financiare në tabelën në vijim nuk administrohen në bazë të vlerës së drejtë dhe për këtë arsye nuk maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Për këto instrumente vlera e drejtë llogaritet vetëm për qëllimet e dhënies së informacionit në shënimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar ose në pasqyrën e të ardhurave të veçanta. Me futjen e SNRF 9, llogaritja e vlerës së drejtë të llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve të pa raportuara me vlerën e drejtë u riklasifikua dhe, ndër të tjera, faktorët e inputeve përdoren gjithashtu edhe në modelet që nuk janë të vëzhgueshme në treg por që kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e llogaritit. Një metodë e thjeshtuar e llogaritjes së vlerës së drejtë për portofolet me pakicë dhe jo pakicë aplikohet për të gjitha transaksionet afatshkurtra (transaksionet me afat maturimi deri në 3 muaj). Vlera e drejtë e këtyre transaksioneve afatshkurtra do të jetë e barabartë me vlerën kontabël të produktit. Për transaksionet e tjera aplikohet metodologjia e përshkruar në seksionin e titulluar Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të raportuara me vlerën e drejtë.

2019 Në mijë Lek	Niveli I	Niveli II	Niveli III	Vlera e drejtë	Vlera kontabël	Diferencat
Aktivët						
Aktivët financiare - kostoja e amortizuar						
Paraja dhe ekuivalentët e saj		25,065,896		25,065,896	25,065,896	-
Letrat me vlerë të borxhit		63,649,574		63,649,574	62,447,834	1,201,740
Hua dhe paradhenie		129,628,607		129,628,607	129,628,607	-
Detyrimet						
Detyrimet financiare - kostoja e amortizuar						
Depozitat		193,409,892		193,409,892	193,421,899	-12,007
Detyrime të tjera financiare		1,235,521		1,235,521	1,235,521	-

Si rezultat i ndryshimit në paraqitjen e pasqyrës së pozicionit financiar, përgatitja e një krahasimi të drejtpërdrejtë të vitit paraprak do të kërkonte kosto dhe përpjekje të panevojshme.

2018 Në mijë Lek	Niveli I	Niveli II	Niveli III	Vlera e drejtë	Vlera kontabël	Diferencat
Aktivët						
Aktivët financiare - kostoja e amortizuar	-					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	22,996,693	22,996,693	22,996,693	-
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	75,977,043	75,977,043	74,427,729	1,549,314
Hua dhe paradhenie	-	-	120,077,213	120,077,213	120,077,213	-
Detyrimet						
Detyrimet financiare - kostoja e amortizuar	-	-	194,534,298	194,534,298	194,549,517	-15,219
Depozitat	-	-	194,235,875	194,235,875	194,251,094	-15,219
Detyrime të tjera financiare	-	-	298,423	298,423	298,423	-

Niveli I Çmimet e tregut të kuotuar

Niveli II Teknikat e vlerësimit të bazuara në të dhënat e tregut

Niveli III Teknikat e vlerësimit nuk bazohen në të dhënat e tregut

21. ANGAZHIMET E HUASË, GARANCITË FINANCIARE DHE ANGAZHIMET E TJERA

Tabela e mëposhtme tregon angazhimet e dhëna për kredinë, garancitë financiare dhe angazhimet e tjera të dhëna.

në mijë LEK	2019	2018
Angazhimet per kredi të dhëna	13,315,474	12,204,151
Garancitë financiare të dhëna dhe zotimet e tjera të dhëna	9,539,592	9,038,241
Totali	22,855,066	21,242,392
Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9	81,898	81,821

Tabela e mëposhtme tregon shumën nominale dhe provizionet për detyrimet jashtë bilancit nga angazhimet dhe garancitë financiare sipas SNRF 9.

2019	Vlera nominale		Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9				
	Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 1	Niveli 2
Banka qendrore	11,256	-	-	-	6	-	-
Bankat	2,311,124	-	-	-	1	-	-
Korporata të tjera financiare	76,213	-	-	-	1,573	-	-
Korporatat jofinanciare	15,366,512	1,381,021	-	-	34,098	6,001	-
Individët	3,479,582	202,884	26,474	-	18,058	2,955	19,206
Totali	21,244,687	1,583,905	26,474	53,736	8,956	19,206	

2018	Vlera nominale		Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9				
	Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 1	Niveli 2
Banka qendrore	11,858	-	-	-	9	-	-
Bankat	2,702,366	757,627	-	-	58	4	-
Korporata të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-
Korporatat jofinanciare	13,470,695	595,094	465	-	26,456	3,219	300
Individët	3,430,117	245,991	28,180	-	21,630	6,412	23,733
Totali	19,615,036	1,598,712	28,645	48,153	9,635	24,033	

22. ANALIZA E CILËSISË SË KREDISË

Analiza e cilësisë së kredive të aktiveve financiare është vlerësimi i probabilitetit të mospagimit të aktiveve në një çast kohor. Duhet të theksohet se për aktivet financiare në Nivelin 1 dhe 2, për shkak të natyrës relative të rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë, nuk është domosdoshmërisht rasti që aktivet e Nivelit 2 kanë një vlerësim më të ulët të kredisë sesa aktivet e Nivelit 1, edhe pse është zakonisht ky rast. Lista e mëposhtme jep një përshkrim të grupit të asetëve sipas probabilitetit të mospagesës:

- Shkëlqyeshëm janë ekspozimet që tregojnë një aftësi të fortë për të përmbushur angazhimet financiare, me probabilitet të mospagesës të papërfillshëm ose zero (vargu me PD 0,0000 - 0,0300 për qind).
- Të fortë janë ekspozimet që tregojnë një kapacitet të fortë për të përmbushur angazhimet financiare, me probabilitet të mospagesës të papërfillshëm ose të ulët (vargu me PD 0.0300 - 0.1878 për qind).
- Mirë janë ekspozimet të cilat demonstrojnë një kapacitet të mirë për të përmbushur angazhimet financiare, me rrezik të mospagesës të ulët (vargu PD 0.1878 - 1.1735 për qind).

22. ANALIZA E CILËSISË SË KREDISË (VAZHDIM)

- Kënaqshëm janë ekspozimet të cilat kërkojnë një monitorim më të afërt dhe tregojnë një aftësi mesatare dhe të drejtë për të përmbushur angazhimet financiare, me rrezik të mospagesës të moderuar (vargu i PD 1.1735 - 7.3344 për qind).
- Nën standardet janë ekspozime të cilat kërkojnë shkallë të ndryshme të vëmendjes së veçantë dhe rreziku i mospagesës është më shqetësues (vargu i PD-së 7.3344 - 100.0 për qind).
- Kredia e zhvlerësuar është ekspozime të cilat janë vlerësuar si të zhvlerësuara (vargu i PD-së është 100.0 për qind).

Tabela në vijim përcakton informacion në lidhje me cilësinë e kredisë të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Kostoja e amortizuar dhe vlera e drejtë nëpërmjet shumave të tjera të të ardhurave përmbledhëse përfaqësojnë vlerën kontabël bruto. Për angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë shumat e kryera ose të garantuara. Tabela në vijim tregon vlerat kontabël të aktiveve financiare - kostoja e amortizuar sipas kategorive të klasifikimit dhe niveleve:

2019	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Në mijë Lek	HPK 12 mujore	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	
i shkëlqyer	65,402	-	-	65,402
i fortë	33,618,091	-	-	33,618,091
i mirë	87,024,832	349,013	-	87,373,846
i kënaqshëm	54,568,551	3,581,088	-	58,149,639
nënstandarte	3,521,292	3,714,169	-	7,235,461
Kredia e zhvlerësuar	-	-	12,434,437	12,434,437
Të pa klasifikuar	3,449,519	68,815	-	3,518,334
Vlera kontabël bruto	182,247,688	7,713,085	12,434,437	202,395,210
Zhvlerësimi i akumuluar	-802,266	-675,658	-8,944,254	-10,422,178
Vlera kontabël	181,445,422	7,037,427	3,490,183	191,973,032

2018	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Në mijë Lek	HPK 12 mujore	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	
i shkëlqyer	-	-	-	-
i fortë	38,421,880	-	-	38,421,880
i mirë	95,663,089	583,103	-	96,246,192
i kënaqshëm	43,978,765	4,172,249	-	48,151,014
nënstandarte	3,062,972	3,955,953	-	7,018,925
Kredia e zhvlerësuar	-	-	13,795,441	13,795,441
Të pa klasifikuar	2,589,492	95,076	-	2,684,568
Vlera kontabël bruto	183,716,198	8,806,379	13,795,441	206,318,019
Zhvlerësimi i akumuluar	-596,366	-756,901	-10,459,811	-11,813,078
Vlera kontabël	183,119,831	8,049,481	3,335,629	194,504,941

Kategoria e pa klasifikuar përfshin aktivet financiare për disa konsumatorë të pakicës për të cilët nuk ka asnjë vlerësim. Vlerësimi është i bazuar në faktorë cilësorë.

22. ANALIZA E CILËSISË SË KREDISË (VAZHDIM)

Tabela në vijim tregon vlerat nominale të angazhimeve jashtë bilancit sipas kategorive dhe niveleve të klasifikimit:

2019	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Në mijë Lek	HPK 12 mujore	HPK gjatë gjithë jetës	HPK gjatë gjithë jetës	HPK 12 mujore
i shkëlqyer	585,010	-	-	585,010
i fortë	1,591,364	-	-	1,591,364
i mirë	7,949,131	222,184	-	8,171,315
i kënaqshëm	8,733,175	1,276,787	-	10,009,962
Nënstandarte	496,533	81,588	-	578,121
Kredia e dëmtuar	-	-	26,474	26,474
Pa klasifikuar	1,889,474	3,346	-	1,892,820
Totali	21,244,687	1,583,905	26,474	22,855,066
Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9	53,736	8,956	19,206	81,898

Kategoria e pashembullt përfshin angazhime jashtë bilancit për disa klientë me pakicë për të cilët nuk ka asnjë vlerësimi. Vlerësimi bazohet në faktorët cilësor.

2018	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Në mijë Lek	HPK 12 mujore	HPK gjatë gjithë jetës	HPK gjatë gjithë jetës	HPK 12 mujore
i shkëlqyer	-	750,000	-	750,000
i fortë	2,641,413	7,627	-	2,649,040
i mirë	6,600,777	245,933	-	6,846,709
i kënaqshëm	6,367,961	460,546	-	6,828,507
Nënstandarte	342,191	129,552	-	471,743
Kredia e dëmtuar	-	-	28,645	28,645
Pa klasifikuar	3,662,693	5,054	-	3,667,747
Totali	19,615,034	1,598,712	28,645	21,242,391
Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9	48,152	9,636	24,033	81,821

23. KOLATERALI DHE EKSPOZIMI MAKSIMAL NDAJ RREZIKUT TË KREDISË

Duhet të theksohet se vlerat e kolateralit të paraqitura në tabela janë vlerësuar në vlerën maksimale të vlerës së mbartur bruto të aktivitetit financiar. Tabela e mëposhtme tregon aktivitetet financiare me kosto të amortizuara që i subjekti i zhvlerësimi:

2019 Në mijë Lek	Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut	Vlera e drejtë e kolateralit	Ekspozimi i rrezikut të kredisë jashtë kolateralit
Banka qendrore	6,085,715	-	6,085,715
Qeveritë e përgjithshme	54,433,708	-	54,433,708
Bankat	36,614,093	-	36,614,093
Korporata të tjera financiare	3,570,922	-	3,570,922
Korporatat jofinanciare	55,781,984	46,258,681	9,523,303
Individët	39,374,351	14,927,981	24,446,370
Angazhimet /garancitë e lëshuara	23,537,546	3,620,077	19,917,469
Totali	219,398,319	64,806,739	154,591,580

2018 Në mijë Lek	Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut	Vlera e drejtë e kolateralit	Ekspozimi i rrezikut të kredisë jashtë kolateralit
Banka qendrore	6,100,453	-	6,100,453
Qeveritë e përgjithshme	60,108,640	-	60,108,640
Bankat	41,238,849	-	41,238,849
Korporata të tjera financiare	2,705,590	-	2,705,590
Korporatat jofinanciare	52,597,711	28,530,316	24,067,395
Individët	34,814,437	10,035,027	24,779,410
Angazhimet /garancitë e lëshuara	21,792,051	5,445,743	16,346,308
Totali	219,357,731	44,011,086	175,346,645

Tabela në vijim përmban detajet e ekspozimit maksimal nga aktivitetet financiare në Nivelin 3 dhe kolateralin përkatës:

2019 Në mijë Lek	Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut (Niveli 3)	Vlera e drejtë e kolat- eralit (Niveli 3)	Ekspozimi i rrezikut të kredisë jashtë kolat- eralit (Niveli 3)	Zhvlerësimi
Korporatat jofinanciare	10,030,054	2,284,044	7,336,678	-7,353,993
Individët	2,404,385	354,143	2,065,951	-1,590,261
Angazhimet / garancitë e lëshuara	26,474	215	26,259	-19,206
Totali	12,460,913	2,638,402	9,428,888	-8,963,460

2018 Në mijë Lek	Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut (Niveli 3)	Vlera e drejtë e kolat- eralit (Niveli 3)	Ekspozimi i rrezikut të kredisë jashtë kolat- eralit (Niveli 3)	Zhvlerësimi
Korporatat jofinanciare	11,593,817	2,355,409	9,238,408	-8,808,343
Individët	1,757,867	103,142	1,654,725	-1,359,044
Angazhimet / garancitë e lëshuara	28,645	520	28,125	-24,033
Totali	13,380,329	2,459,071	10,921,258	-10,191,420

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë pasqyron një shumë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, vlerën kohore të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Qasja e përgjithshme

Matja e zhvlerësimit për humbjen e pritshme të kredisë mbi aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse është një fushë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme për kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e pagesave. Gjykime të rëndësishme kërkohen në zbatimin e kërkesave të kontabilitetit për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë, ndër të tjera:

- Përcaktimi i kritereve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë
- Vendosja e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkt / treg dhe humbjet e pritura të kreditit të lidhura
- Krijimi i grupeve të aseteve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritura të kredisë.

Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë

Grupi konsideron që një instrument financiar ka pësuar një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë kur një apo më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose kthyese janë përmbushur:

Kriteret sasiore

Nëse rreziku i kredisë është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, rreziku i një mospagimi në datën e raportimit duhet të krahasohet me rrezikun e një mospërmbushjeje në njohjen fillestare.

Kriteret cilësore

Praktika aktive e administrimit

Nëse bazuar në ndryshimet e treguesve të rrezikut të kredisë të instrumentit financiar, praktika e administrimit të rrezikut të kredisë së Grupit pritet të bëhet më aktive, modeli i zhvlerësimit do të reagojë duke mundësuar caktimin e instrumentit financiar në Nivelin 2, për të cilin humbja e pritshme do të llogaritet përgjatë gjithë jetës. Informacioni i nevojshëm për të zbuluar aktivet e prekura është i disponueshëm në sistemin e parajmërimin të hershëm të RBAL në formën e statusit të rrezikut të klientit. Në përgjithësi, kreditë e këqija të RBAL-it monitorohen më shumë ose kontrollohen, gjë që tregon rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe në modelin e llogaritjes së zbatuar të zhvlerësimit shkakton kalimin në nivelin 2 dhe llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë gjatë jetës.

Kuadri kontraktual i një instrumenti

Nëse ndodhin ndryshime në kuadrin kontraktual të instrumentit, Grupi përdor informacionin mbi nivelin e instrumentit financiar dhe identifikon të gjitha aktivet që kërkohen për të përmbushur kriteret për një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe rrjedhimisht ka mundësi transferohet në Nivelin 2.

30 ditë vonesë

Duke shkelur pragun e 30 ditë vonesë, një instrument financiar do të konsiderohet që ka treguar një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe rrjedhimisht ka mundësi të transferohet në Nivelin 2.

Mospërmbushja e detyrimeve në nivelin e konsumatorit

Në segmentin privat, mospërmbushja e detyrimeve në një instrument të huamarrësit shkakton transferimin e të gjitha instrumenteve e tjera në Nivelin 2, me supozimin se nuk ka një dështim të ekspozimit për Retail ("default flag").

Limiti

Zbatohet një limit dhe instrumenti financiar konsiderohet se ka pësuar një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë, nëse huamarrësi ka kaluar më shumë se 30 ditë vonesë në pagesat e tij kontraktuale. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivet financiare që kanë kaluar më shumë se 30 ditë duhet të transferohen në Nivelin 2, mund të hidhet poshtë.

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

Përjashtimi i rrezikut të ulët të kredisë

Përjashtimi i rrezikut të ulët të kredisë zbatohet brenda Grupit vetëm për segmentin e veçantë të borxhit shtetëror, të përcaktuara nëpërmjet ekspozimeve të borxhit ndaj palëve që i përkasin modelit të vlerësimit shtetëror. Përjashtimi nga rreziku i ulët i kredisë zbatohet pavarësisht nga lloji i palës tjetër brenda modelit të vlerësimit shtetëror. Dhe në qoftë se për borxhin shtetëror, PD njëvjeçar, duke përfshirë informacionin e ardhshëm, është nën 0.5%, rreziku i kredisë konsiderohet i ulët dhe aplikohet Niveli 1. Në të gjitha rastet e tjera, përdoret vetëm rregulli i zakonshëm i ndarjes në Niveli.

Përkufizimi mospërbushjes së detyrimeve (mospagesës) dhe aktiveve të zhvlerësuar

Grupi vlerëson se një aktiv financiar i cili është subjekt i mospagesës është plotësisht i përafuar me përkufizimin e aktivitetit të zhvlerësuar.

Treguesit e "aktivitetit të zhvlerësuar" sipas SNRF 9 janë:

- vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit;
- mospërbushje e detyrimeve ose shkelje e detyrimeve nga huamarrësi;
- njëسيا ekonomike, për arsye ekonomike ose ligjore të palës tjetër në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët, i jep kësaj pale një koncesion që njëسيا ekonomike nuk do ta merrte në konsideratë në kushte të tjera;
- është bërë e mundshme që pala tjetër në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët do të hyjë në proces falimentimi ose në ndonjë riorganizim tjetër financiar; ose;
- zhdukja e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
- blerja ose nisja e një aktiviteti financiar me zbritje të thellë që pasqyron humbjet e pësuar të kredisë, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

Kriteret sasiore

Huamarrësi është më shumë se 90 ditë vonesë për një detyrim material të kredisë. Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se aktiviteti financiar që janë më shumë se 90 ditë vonesë duhet të klasifikohen në Nivelin 3.

Kriteret cilësore

- Huamarrësi plotëson kriterin e pamundësisë për të paguar, i cili tregon se huamarrësi është në vështirësi të konsiderueshme financiare dhe nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e kredisë në tërësi. Treguesit e pamundësisë për të paguar përfshijnë:
- Një detyrim kredie shitet me humbje materiale ekonomike
- Një detyrim kredie i nënshtrohet një ristrukturimi të vështirë
- Një detyrim falimenton / falimenton
- Huamarrësi ka kryer mashtrim
- Huamarrësi është i vdekur
- Një kontratë kredie është ndërprerë para kohe për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar në të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Grupi dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagesës të përdorur për qëllime të administrimit të rrezikut të brendshëm të kredisë. Përcaktimi i mospagesës është aplikuar vazhdimisht për të modeluar probabilitetin e mospagesës (PD), ekspozimin në rast mospagese (EAD) dhe humbjen në rast mospagese (LGD) gjatë llogaritjeve të humbjeve të pritshme të kredisë së Grupit.

Detyrimi i kredisë konsiderohet të mos jetë më në vonesë pas një periudhe prove prej tre muajsh (gjatë muaj pas një ristrukturimi të vështirë për kreditë e individëve), ku gjatë periudhës së provës konsumatori tregoi një disiplinë të mirë pagese dhe asnjë tregues tjetër i pamundësisë për të paguar është vërejtur.

Shpjegimi i inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose përgjatë gjithë jetës, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar. Grupi përfshin parashikimet për kushtet e ardhshme në përcaktimin e PD-së 12-mujore dhe përgjatë gjithë jetës, EAD dhe LGD. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë produkti i skontuar i probabilitetit të mospagesës (PD), humbjes në rast mospagese (LGD) dhe ekspozimit në rast mospagese (EAD). Për zbritjen e HPK përdoret norma efektive e interesit.

Baza për të gjitha çmuarjet e parametrave përbërës të HPK të retail-it janë modelet respektive Shtylla I / II të zhvilluara brenda kuadrit të Basel-it.

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

Matja e HPK

Inputet kryesore në matjen e HPK janë struktura termike e variablave në vijim:

- probabilitetit të mospageses (PD);
- humbja në rast mospagese (LGD); dhe
- ekspozimi në rast mospagese (EAD).

HPK-të përbëjnë një vlerësim të probabilitetit të ponderuar të humbjeve të kredisë. Ato maten si më poshtë vijon:

- *aktivet financiare që nuk janë të zhvlerësuar në datën e raportimit:* si vlera aktuale e të gjitha mjeteve monetare (p.sh. diferenca midis flukseve të mjeteve monetare ndaj njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Grupi pret të marrë);
- *aktivet financiare që janë të zhvlerësuar në datën e raportimit:* diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar;

HPK për ekspozimet në Nivelin 1 llogaritet duke shumëzuar PD-në 12-mujore me LGD dhe EAD, ndërkohë, HPK përgjatë gjithë jetës llogaritet duke shumëzuar PD-në e përgjatë gjithë jetës me LGD dhe EAD. HPK janë skontuar duke përdorur normat fillestare të interesit efektiv.

Probabiliteti i mospagesës (PD)

Probabiliteti i mospagesës paraqet mundësitë që një huamarrës të mos përmbush e tij detyrimet financiare ose gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Duke filluar me parametrizimin e përjasjes së bazuar në vlerësimet e brendshme (IRB), një numër përshtatjesh janë të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me SNRF 9 për humbjet e pritshme të kredisë (HPK):-

- Kalimi nga vlerësimet përmes një cikli kohor (PCK) në vlerësimet në një moment në-kohë (MNK)
- Aplikimi i parashikimeve për kushtet e ardhshme duke përfshirë faktorët e pritur makroekonomikë, nën sisteme dhe idiosinkretike
- Zgjatja e shtrirjes kohore në rastin e Nivelit 2 (HPK përgjatë gjithë jetës)
- Perjashtimi i faktoreve konservator dhe minimeve regullatoreve nga humbja dhe cmurja e eksposimeve me mospagesë

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar profilin e paracaktuar të shumave të huadhënies dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Modelet shtetërore, lokale dhe rajonale, shoqëritë e sigurimeve dhe ndërmarrjet e investimeve kolektive;
- Klientet e korporatave, financimet e projekteve dhe institucionet financiare;
- Kreditë hipotekore dhe huadhënie të tjera për individë.

Humbja në rast mospagese (LGD)

Humbja në rast mospagese, paraqet pritshmerine që ka Grupi për shkallen e humbjes lidhur me ekspozimin që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose përgjatë gjithë jetës, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar humbjen në rast mospagese të vlerës së mbetur, të cilat mund të grupohen sipas kategorive të mëposhtme:

- Modeli shtetëror, humbja në rast mospagimi është përllogaritur duke përdorur burimet e tregut, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për humbjet për segmentin shtetëror. Metoda bazohet në ngjarje të jashtme të mospageses në sektorin shtetëror për periudhën midis 1998 dhe 2015. Vetëm GDP rezultoi të ketë një ndikim të rëndësishëm.
- Për klientët korporata, financimet e projekteve, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, shoqëritë e sigurimeve, humbja në rast mospagese krijohet duke aktualizuar flukset e perfitura gjatë procesit të punës. Parashikimet për kushtet e ardhshme përfshihen në këtë humbje duke përdorur modelin Vasicek.
- Për kreditë me hipotekë dhe kreditë të tjera të tregtueshme për individë: Për portofolet me modele IRB të zhvilluara, vlerat e LGD sipas Basel-it përdoren si pikënisje për nxjerrjen e vlerësimeve LGD sipas SNRF 9. Dallimi kryesor

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

midis LGD sipas Basel-it dhe LGD sipas SNRF 9 është se për Basel-in synimi është që të ketë një vlerësim mesatar të PCK-së për vlerën e skontuar të rikuperimit pas periudhës së mospagesës duke zgjeruar marzhet e konservatorizmit në kuadër të parimit të kujdesit, ndërsa për SNRF 9 vlerësimi LGD duhet të jetë një moment kohe të paanshëm që duhet të marrë parasysh informacionin e ardhshëm. Prandaj, vlerësimet e LGD sipas Basel-it duhet të përshtaten për qëllimet e SNRF 9. Rregullimet e nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me SNRF 9 janë si më poshtë:

- heqjen e marzhave konservatore (p.sh. marzhi i rënies, marzhi i gabimit të vlerësimit);
- eliminimi i niveleve rregullatore dyshemel;
- rregullimi i efektit të normave të ndryshme të skontimit të përdorur në LGD të Basel-it për të arritur te EIR;
- largimin e kostove indirekte nga vlerësimet LGD, dhe
- kryerjen e rregullimeve për të marrë parasysh parashikimet përkatëse makroekonomike (nëse ekziston dëshmi e qartë se ekziston një lidhje midis normave të rimëkëmbjes dhe faktorëve makroekonomikë).

Në rrethanat e kufizuara ku disa inpute nuk janë plotësisht të disponueshme modele të rimëkëmbjes alternative, për llogaritjen përdoret benchmark-i i inputeve dhe gjykimi i ekspertëve.

Ekspozimi në rast mospagese (EAD)

Ekspozimi në rast mospagese bazohet në shumat që Grupi pret që të jetë në borxh në kohën e mospagesës, gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. EM-të dymbëdhjetë mujore dhe gjatë gjithë jetës përcaktohen në bazë të profilit të prishëm të pagesës, i cili ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet amortizuese dhe huatë e shlyerjes me një shumë të vetme, kjo bazohet në ripagimet kontraktuale që i detyrohen huamarrësit gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore ose gjatë gjithë jetës. Aty ku është e rëndësishme, supozimet e ripagimit / ri-financimit të hershëm konsiderohen gjithashtu në llogaritje.

Për produktet me pagesa fikse të papërcaktuara, ekspozimi në rast mospagese parashikohet duke marrë bilancin aktual të tërhequr dhe duke shtuar një faktor konvertimi kreditor i cili lejon tërheqjen e pritit të kufirit të mbetur deri në kohën e shlyerjes. Marzhet rregullatorë të kujdesshëm hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rrethanat e kufizuara ku disa inpute nuk janë plotësisht në dispozicion, krahasimi i inputeve përdoret për llogaritjen.

Aktivitet financiare të ristrukturuara

Nëse kushtet e një aktivi financiar rinegocionohen ose modifikohen ose një aktiv financiar ekzistues zëvendësohet me një të ri për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet vlerësimi nëse aktivitetet financiare duhet të çregjistrohen dhe HPK të matet si më poshtë.

- Nëse ristrukturimi i pritit nuk do të rezultojë në çregjistrimin e aktivitetit ekzistues, atëherë flukset e pritshme të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet financiare të modifikuara përfshihen në llogaritjen e mungesës së parasë së gatshme nga aktivi ekzistues;
- Nëse ristrukturimi i pritit do të rezultojë në çregjistrimin e aktivitetit ekzistues, atëherë vlera e drejtë e pritit e aktivitetit të ri trajtohet si fluksi i parave të gatshme nga aktivi financiar ekzistues në kohën e çregjistrimit të tij. Kjo shumë përfshihet në llogaritjen e mungesës së parasë së gatshme nga aktivi financiar ekzistues që zbritet nga data e pritit e mosnjohjes deri në datën e raportimit duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar ekzistues.

Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut të kredisë

Pothuajse të gjitha provizionet sipas SNRF 9 maten kolektivisht. Vetëm për ekspozimet për shoqëritë në nivelin 3, shumica e provizioneve janë vlerësuar në mënyrë individuale.

Nëse informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur për të matur HPK nuk është i disponueshëm në bazë të instrumentit individual, HPK-ja për gjithë jetën për aktivitetet në nivelin 3 njihet në baza kolektive që merr parasysh informacionin gjithëpërfshirës të rrezikut të kredisë - trajtim i njëjtë si për aktivitetet në nivelin 1 dhe 2. Në ekspozimet për individë, pothuajse për të gjitha rastet përdoret qasja kolektive, duke pasur parasysh se shumica e rasteve vlerësohen kolektivisht në bazë të informatave të humbjeve historike, ndërsa vlerësimi individual kryhet në mënyrë të jashtëzakonshme vetëm për rastet kur njësitë ekonomike ka të gjithë grupin e të dhënave të nevojshme për të bërë vlerësimin e plotë të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar.

Në këtë kuptim, "RBAL Retail Risk" konsideron se mënyra më e përshtatshme për të pasqyruar përvojën e humbjes historike në vlerësimin e flukseve monetare të pritura të një ekspozimi të parazgjedhur të pasiguar është duke përdorur

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

të ashtuquajturën Parametrat më të mira të Humbjes së Pritshme (PHP). Sipas përkufizimit, ky parametër pasqyron potencialin më të mundshëm të humbjes për llogaritë në rast mospagese të cilat kanë profil të ngjashëm të rrezikut dhe të rikuperimit dhe siguron një nivel të llogaritit të llogaritit statistikisht të humbjes për llogaritë e tilla. Prandaj, duhet të sigurohet që përdorimi i PHP për të regulluar flukset monetare kontraktuale në vlerësimin e arkëtimit të tyre të llogaritit aplikohet në një grup homogjen të llogarive.

Parashikimet për kushtet e ardhshme

Vlerësimi i rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë, të dyja përfshijnë parashikimeve për kushtet e ardhshme. Grupi ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesore ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritura të kreditit për çdo portofol.

Këto variabla ekonomike dhe ndikimi i tyre lidhur me probabilitetin e mosplotësimit, humbja e dhënë në mungesë dhe ekspozimi i parazgjedhur varion nga lloji i kategorisë. Parashikimet e këtyre variablave ekonomike (skenari bazë ekonomik) sigurohen nga RBI Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin pikëpamjen më të mirë të ekonomisë gjatë tre viteve të ardhshme. Grupi i informacioneve të ardhshme kërkon gjithashtu orën e kredisë që përdoret për përmirësimin e regresionit, i cili riprodhon gjendjen aktuale të ciklit të kredisë dhe rrjedhjen e dukshme të zhvillimit të ciklit të kredisë. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomike për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, është përdorur një përfaqje e kthimit mesatar, që do të thotë se variablat ekonomike kanë tendencë të jenë një normë mesatare afatgjatë ose një mesatare afatgjatë norma e rritjes deri në maturim. Ndikimi i këtyre variablave ekonomike në probabilitetin e mosplotësimit, humbjes së parazgjedhur dhe ekspozimit në mungesë është përcaktuar duke kryer regresionin statistikor për të kuptuar ndryshimet e ndikimit në këto variabla kanë pasur historikisht normat e mungesës dhe mbi komponentët e humbjes në rast mospagese dhe ekspozimit në rast mospagese.

Përveç skenarit ekonomik bazë, Raiffeisen Research vlerëson gjithashtu një skenar optimist dhe pesimist për të siguruar që jo-linearitetet janë kapur. Grupi ka arritur në konkluzionin se tre ose më pak skenarë kapin në mënyrë të drejtë jo-linearitetin. Vlerësimi i ekspertëve për rreziqet idiosinkratike është zbatuar gjithashtu në këtë proces në nivelin e kërkimit të Raiffeisen në koordinim me administrimin e rrezikut të Grupit, duke rezultuar në përshtatje selektive ndaj skenarëve optimistë dhe pesimistë. Në rast të një paragjykim të mundshëm negativ ose pozitiv të treguesve të zgjedhur makroekonomike, kryhet një korigjim i mundshëm i paragjykimëve. Në këtë aspekt merret parasysh shkalla e rezultateve të mundshme që është përfaqësuese për secilin skenar të zgjedhur. Humbjet e pritshme të ponderuara të probabilitetit të kredisë përcaktohen duke drejtuar secilin skenar nëpërmjet modelit përkatës të humbjes së kredisë (HPK) dhe duke e shumëzuar atë me ponderimin e duhur të skenarit.

Ashtu si me çdo parashikim ekonomik, projeksionet dhe gjasat e shfaqjes janë subjekt i një shkalle të lartë të pasigurisë së qenësishme dhe prandaj rezultatet aktuale mund të jenë dukshëm të ndryshme nga ato të parashikuara. Grupi i konsideron këto parashikime për të përfaqësuar vlerësimin më të mirë të rezultateve të ardhshme dhe për të mbuluar çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme brenda portofoleve të ndryshme të Grupit.

Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në ndjeshmërinë e lejimit të humbjeve të pritshme të kredisë janë si më poshtë:

- Produkti i brendshëm bruto (të gjitha portofolet)
- Norma e papunësisë (të gjitha portofolet)
- Norma afatgjata e obligacioneve të qeverisë (portofole jo-pakicë veçanërisht)

Në tabelën e mëposhtme jepet një krahasim midis zhvlerësimit të akumuluar të raportuar për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare në Nivelin 1 dhe 2 (peshuar nga 25 për qind optimist, 50 për qind bazë dhe 25 për qind skenarë pesimistë) dhe pastaj çdo skenar i ponderuar me 100 për qind më vete. Skenarët optimistë dhe pesimistë nuk pasqyrojnë raste ekstreme, por mesatarja e skenarëve që shpërndahen në këto raste. Ky informacion është dhënë për qëllime ilustruese.

2019	31/12/2019	100%	100%	100%
Në mijë Lek	(25/50/25%)	Optimist	Bazë	Pesimist
Zhvlerësimi i akumuluar (Niveli 1 & 2)	1,474,619	1,282,419	1,480,324	1,655,408

24. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

2018	31/12/2018	100%	100%	100%
Në mijë Lek	(25/50/25%)	Optimist	Bazë	Pesimist
Zhvlrësimi i akumuluar (Niveli 1 & 2)	1,343,364	1,311,270	1,231,805	1,405,133

Fshirjet nga bilanci

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose plotësisht) kur nuk ka shpresa të arsyeshme për rimëkëmbjen. Kjo ndodh kur huamarrësi nuk ka më të ardhura nga operacionet dhe vlerat kolaterale nuk mund të gjenerojnë flukse të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer shumat që i nënshtrohen heqjes. Për ekspozimin e shoqërive në falimentim, kreditë shënohen në vlerën e kolateralit nëse shoqëria nuk gjeneron flukse monetare nga biznesi i tij operativ. Biznesi me pakicë merr në konsideratë faktorët cilësorë. Në rastet kur nuk është bërë pagesa për një vit, shumat e papaguara cregjistrohen kur aktivet e zhvlrësuar mund të vazhdojnë të jenë subjekt i veprimeve përbarimore.

Për ekspozimin e shoqërive të vlerësuar si biznes me aktivitet të pasigurtë, kreditë janë zhvlrësuar në vlerën e kolateralit nëse shoqëria nuk gjeneron flukse të mjeteve monetare nga biznesi i saj operacional. Biznesi me pakicë merr në konsideratë faktorët cilësorë. Në rastet kur nuk është bërë pagesa për një vit, shumat e papaguara janë shlyer këtu. Shuma kontraktuale e papaguar mbi Aktivet financiare të cilat janë shlyer gjatë periudhës raportuese dhe që ende i nënshtrohen veprimtarisë së përbarimit janë të pa-matura / janë në mijë lekë..

25. EKSPOZIMI I BRENDSEHEM SIPAS NIVELEVE

Portofoli i kredisë i Grupit është shumë i larmishëm në aspektin e tipit të klientit, rajonit gjeografik dhe industrisë. Përqendrimet e emrave të vetëm janë gjithashtu të administruara në mënyrë aktive (bazuar në konceptin e grupit të klientëve të lidhur) me kufizime dhe raportim të rregullt. Si pasojë, granulariteti i portofolit është i lartë. Tabela e mëposhtme tregon aktivet financiare - koston e amortizuar bazuar në palët dhe Nivelit përkatëse. Kjo tregon fokusin e Grupit në shoqëritë jofinanciare dhe individët:

25. EKSPOZIMI I BRENDSEHEM SIPAS NIVELEVE (VAZHDIM)

2019	Vlera kontabël bruto			Vlera e akumuluar			HPK Raporti i mbulimit		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Banka qendrore	6,085,938.00	-	-	-223	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Institucionet qeveritare	54,538,321	-	-	-83,305	-	-	0.15%	0.00%	0.00%
Bankat	36,614,457	-	-	-364	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
USD	659	26	9	131	252	150	91	-	-	-	-	-

2018 në mijë Lek	Total	< 3 m	> 3 deri 6 m	> 6 deri 12 m	> 1 deri 2 v	> 2 deri 3 v	> 3 deri 5 v	> 5 deri 7 v	> 7 deri 10 v	> 10 deri 15 v	> 15 deri v	>20v
ALL	-2,127	161	-618	-258	-1,633	123	-597	-30	269	209	154	93
CAD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
CHF	-10	-	-	-8	-1	-	-	-	-	-	-	-
EUR	702	21	98	-365	112	503	230	2	39	50	12	10
GBP	46	4	3	39	-	-	-	-	-	-	-	-
USD	779	27	12	153	165	150	272	-	-	-	-	-
CZK	-5,017	310	-495	-12	-1,799	-190	-627	-1,095	-335	-458	-244	-71

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT

Struktura e Financimit

Struktura e financimit të Grupit është shumë e fokusuar në marrjen e depozitave me pakicë në tregun vendas. Burimet e ndryshme të financimit përdoren në përputhje me parimin e diversifikimit. Këto përfshijnë përdorimin e kredive të financimit të palës së tretë dhe skemat e ndarjes së rrezikut me organizata të ndryshme mbikombëtare. Pjesërisht për shkak të limiteve të kufizuara të vendit dhe pjesërisht për shkak të çmimeve të dobishme, Grupi po përdor gjithashtu huamarrje ndërbankare dhe vendosje me bankat vendase dhe ndërkombëtare.

Parimet

Administrimi i likuiditetit në Grup siguron disponueshmërinë e vazhdueshme të fondeve të nevojshme për të mbuluar operacionet e përditshme të biznesit. Prandaj është një nga proceset më të rëndësishme të biznesit në drejtimin e përgjithshëm të Grupit. Mjaftueshmëria e likuiditetit sigurohet përgjatë gjithë spektrit të maturimit si nga një aspekt ekonomik ashtu edhe nga një rregullator.

Në perspektivën ekonomike, Grupi RBI ka krijuar një kuadër qeverisjeje që përfshin kufijtë e brendshëm dhe masat e kontrollit mbi pozicionet e likuiditetit, që është në përputhje me Parimet për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit të Lartë dhe Mbikëqyrjen e themeluar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. Grupi gjithashtu ka zbatuar të njëjtin kuadër, si një nga bankat e rrjetit të Grupit RBI.

Komponenti rregullator trajtohet duke përmbushur kërkesat e raportimit sipas Basel III (Raporti i mbulimit të likuiditetit, Raporti neto i financimit të qëndrueshëm dhe matjet shtesë të monitorimit të likuiditetit) dhe duke mbajtur kërkesat minimale përkatëse në formën e kufijve rregullatorë. Për më tepër, Grupi ka shtuar kuadrin e likuiditetit bazuar në grup, kërkesat shtesë për likuiditet dhe raportim të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Përgjegjësia dhe organizimi

Përgjegjësia për të siguruar nivele të përshtatshme të likuiditetit qëndron në Bordin e Administrimit. Megjithatë, sa i përket funksioneve, anëtarët përgjegjës të Bordit janë Kryeshafi Ekzekutiv (Thesari dhe IB) dhe Zytari Kryesor i Rrezikut / Zytari Kryesor Financiar. Rrjedhimisht, proceset lidhur me rrezikun e likuiditetit kryhen kryesisht nga dy sektorë brenda Grupit. Së pari, Departamenti i Thesarit / Dhoma e tregtimit administrojnë pozicionet e rrezikut të likuiditetit brenda

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)

strategjisë, udhëzimeve dhe parametrave të vendosura nga vendimet e marra në takimet e Komitetit të Aktivit/Pasivit (KAP) të cilat pasqyrojnë të gjitha kufizimet rregullatore.

Së dyti, këto janë monitoruar dhe mbështetur nga ndarja e pavarur e Rrezikut të Integruar (Departamenti i Rrezikut të Tregut). Departamenti i Rrezikut të Tregut mat dhe zbaton kufizime në pozicione të ndryshme të likuiditetit, si dhe monitoron pajtueshmërinë e tyre. Përveç funksioneve të lartpërmendura, KAP dhe Departamenti i Kërkimeve janë përgjegjëse për zbatimin e metodologjisë së gjerë të Grupit për modelet e rrezikut të likuiditetit.

Strategjia e Likuiditetit

Objektivat strategjike të likuiditetit të Grupit përfshijnë vetë-qëndrueshmërinë e pozicionit të likuiditetit të Grupit, stabilizimin e vazhdueshëm të bazës së depozitave të klientëve dhe pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat rregullatore dhe me politikat dhe kufijtë e brendshëm. Një objektivi tjetër është shmangia e likuiditetit të tepërt të kushtueshëm dhe shfrytëzimi eficient i fondeve. Njësitë e Administrimit të Rrezikut të Likuiditetit (Dhoma e Thesarit / Tregtisë, Rreziku i Tregut, KAP dhe Kërkimet) në Grup kanë një sërë masash të drejtpërdrejta ose indirekte për të drejtuar bilancet dhe pozicionet e likuiditetit të Grupit.

Dhoma e Thesarit / Tregtisë është e angazhuar për të arritur të gjithë treguesit kryesorë të performancës (KPIs) dhe për të qenë në përputhje me parimet e bazuara në rrezik. Treguesit kryesorë të performancës përfshijnë objektiva të përgjithshme (kthimi nga kapitalin i rregulluar me rrezikun (KKRR) ose raportet e mbulimit), si dhe objektivat specifike të Thesarit për likuiditet (si një horizont minimal i mbijetesës në skenarët e përcaktuar të stresit ose diversifikimin e strukturës së rifinancimit). Përveç arritjes së një kontributi strukturor nëpërmjet transformimit të maturitetit që pasqyron likuiditetin dhe rrezikun e tregut të parashtruar nga Grupi, Dhoma e Thesarit / Tregtisë ndjek një politikë të matur dhe të qëndrueshme të rrezikut në administrimin e bilancit të saj.

Kuadri i Rrezikut të Likuiditetit

Grupi parashikon rregullisht pozicionin e saj të likuiditetit nën vëmendjen e vazhdueshme dhe thekson skenarët e hendekut të likuiditetit, si dhe periudhën e mbijetesës së stresit të matur brenda vendit dhe në rast se është e nevojshme, Raportin e Mbulimit të Likuiditetit (RML). Parashikimet e përdorura për këto parashikime janë kryesisht dinamika e bilancit (maturitetit e burimeve kryesore të financimit, depozitat e klientëve, institucionet financiare dhe kreditë e tjera) dhe disburimet e reja të planifikuara të kredisë. Përveç kësaj, merret në konsideratë edhe stoku i planifikuar i depozitave me afat të korporatave, llogaritë rrjedhëse të korporatave dhe financimi afatshkurtër. Me qëllim të projektimit të RML-së, depozitat e bankave sovraane dhe qendrore janë gjithashtu relevante dhe konsiderohen. Aktivitetet e financimit kalibrohen duke marrë parasysh parashikimet e matësve të likuiditetit (vijmësia, theksimi i hendekut të likuiditetit dhe RML).

Raportet e brendshme dhe rregullatore të likuiditetit gjenerohen në bazë të supozimeve të modelimit të veçantë. Ndërsa raportet rregullatore llogariten mbi specifikimet e dhëna nga autoritetet, raportet e brendshme janë modeluar me supozime nga vëzhgimet empirike.

Sjellja ndaj rrezikut dhe niveli i likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit monitorohet në nivel Grupi dhe në nivel të njësisë individuale dhe është i kufizuar me anë të një sistemi gjithëpërfshirës. Kufijtë janë të përcaktuar si në një biznes normal ashtu edhe në atë të nënshtruar ndaj stresit. Në përputhje me sjelljen e përcaktuar të rrezikut, Grupi ka një horizont mbijetese prej disa muajsh (TTW) në një skenar të stresit të rëndë dhe të kombinuar (stres reputacioni dhe tregu). Kjo sigurohet nga profili pozitiv i likuiditetit dhe nga një zbutës mjaft i lartë i likuiditetit. Në një mjedis normal të vazhdueshëm, transformimi i maturitetit mbulohe plotësisht nga zbutës i likuiditetit në dispozicion në periudhën afatmesme. Kjo do të thotë që pozicioni kumulativ i likuiditetit për një periudhë deri në një vit është pozitiv. Në afat të gjatë (një vit ose më shumë), transformimi i maturitetit lejohet deri në një nivel të caktuar. Për modelet e brendshme, këto kufizime plotësohen nga kufijtë për pajtueshmërinë me raportet rregullatore të likuiditetit, siç është raporti i mbulimit të likuiditetit (RML). Të gjitha limitet e pozicionit të likuiditetit përmbushen në baza ditore. Përveç kësaj, Grupi është në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit, i cili rregullohet me rregulloren nr. 71, datë 14.10.2009, ndryshuar me rregulloren nr.75, datë 26.10.2011 dhe ndryshuar më tej me rregulloret nr. 28, datë 27.03.2013 dhe nr. 14, datë 7.2.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë, Grupi llogarit dhe garanton përputhjen e "aktiveve likuide me raportin afatshkurtër të detyrimeve" në baza ditore.

Kufijtë e Likuiditetit

Grupi duhet të përllogarisë dhe të sigurojë në çdo kohë rishikimin e raportit të aktiveve afatshkurtra ndaj detyrimeve afatshkurtra:

- të shprehur në monedhën vendase (LEK) me një nivel minimal prej 15% (pesëmbëdhjetë përqind);
- të shprehur në monedhë të huaj (FCY) me një nivel minimal prej 20% (njëzet përqind);
- si shumë me një nivel minimal prej 20% (njëzet përqind).

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)

Monitorimi i likuiditetit

Grupi përdor një sërë instrumentesh matëse të personalizuar dhe tregues të parajmërimit të hershëm, të cilat i japin Bordit të Administrimit dhe Drejtimit të lartë informacionin përpara në kohë. Kuadri rregullator sigurohet që Grupi mund të vazhdojë të operojë në një periudhë të vështirë stresi.

Monitorimi i limiteve dhe raportimi mbi përputhjen me limitet kryhet në mënyrë të rregullt dhe efektive. Çdo shkelje e kryer nga linja të ndryshme biznesi të Grupit, raportohet në KAP të Grupit dhe përshkallëzohet. Në raste të tilla, ndërmerren hapat e duhur në konsultim me njësinë përgjegjëse ose çështja përshkallëzohet në instancën tjetër më të lartë përgjegjëse.

Raportet e likuiditetit sipas rregullatorit lokal

Raportet e likuiditetit sipas rregullatorit lokal përlogariten në baza ditore dhe raportohen çdo javë nga departamenti i rrezikut të tregut. Rezultatet raportohen në departamentin e Thesarit, i cili është në dijeni të pozicionit aktual të likuiditetit të Grupit në raport me kërkesat e rregullatorit lokal. Thesari është përgjegjës për zvogëlimin ose rritjen e tepricës së likuiditetit në varësi të pozicionit aktual.

Testimi i stresit të likuiditetit

Testet e stresit kryhen për njësitë individuale të Grupit në baza ditore dhe në nivel Grupi në baza javore, në RBI HO. Testet mbulojnë tre skenarë (tregun, emrin e mirë dhe krizën e kombinuar), duke konsideruar efektet e skenarëve për një periudhë disa mujore dhe paraqesin që ngjarjet e stresit mund të rezultojnë njëkohësisht në një kërkesë likuiditeti në kohë për disa valuta. Skenarët e stresit përfshijnë financimin kryesor dhe rreziqet e likuiditetit të tregut, pa marrë parasysh efektet e dobishme të diversifikimit. Kjo do të thotë se në testet e stresit të Grupit, të gjitha njësitë e rrjetit janë njëkohësisht subjekt i një krize të kombinuar të theksuar për të gjitha produktet e tyre kryesore. Rezultatet e testeve të stresit raportohen tek Shefi i Rrezikut dhe Shefi i Financës, si dhe tek anëtarët e tjerë të Drejtimit në baza javore; ato gjithashtu formojnë një komponent kyç në takimet mujore të KAP dhe përfshihen në planifikimin strategjik dhe në planifikimin e emergjencave të Grupit.

Një qasje konservatore miratohet kur përcaktohen raportet e flukseve dalëse në bazë të të dhënave historike dhe opinioneve të ekspertëve. Simulimi supozon mungesën e qasjes në tregun e parasë ose të kapitalit dhe njëkohësisht flukseve dalëse të depozitave të klientëve. Në këtë drejtim, rreziku i përqendrimit të depozitave përcaktohet duke vendosur raporte më të larta të flukseve dalëse për klientët e mëdhenj. Më tej, supozimet mbi stresin formulohen për tërheqjen e garancive dhe detyrimet e kredive. Përveç kësaj, pozicionet e zbutësve të likuiditetit përshtaten me skontimet për të mbuluar rreziqet e lëvizjeve të pafavorshme të tregut dhe vlerësohen daljet e mundshme të flukseve që rrjedhin nga transaksionet derivative të kolateralit. Grupi vazhdimisht monitoron nëse supozimet e stresit janë ende të përshtatshme apo nëse ka rreziqe të reja të cilat duhet të merren parasysh. Koncepti “në kohë reale” është përcaktuar si instrument kryesor i kontrollit për administrimin e përditshëm të likuiditetit dhe për këtë arsye është një përbërës kryesor i planifikimit financiar dhe buxhetimit. Ky koncept është thelbësor në përcaktimin e raporteve të performancës në lidhje me likuiditetin.

Zbutësit e Likuiditetit

Siç paraqitet nga raportet e përditshme të rrezikut të likuiditetit, Grupi mban dhe administron në mënyrë aktive zbutësit e likuiditetit, duke përfshirë aktivet afatshkurtra me cilësi të lartë (AACL) të cilat janë gjithmonë të mjaftueshme për të mbuluar flukset dalëse neto të parashikuara në skenarët e krizës. Grupi mban portofole të letrave me vlerë afatshkurtra të pagarantuara në shuma të konsiderueshme dhe të tregtueshme në ankandet e Bankës Qendrore, me qëllim që të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm në monedhën vendase. Grupi është përgjegjëse për sigurimin e disponueshmërisë së zbutësve të likuiditetit, duke testuar aftësinë e saj për të përdorur fondet e Bankës Qendrore e duke vlerësuar vazhdimisht pozicionin e kolateralit në përputhje me vlerën e tyre të tregut, si dhe kontrollin e kapacitetit kundërbalancues, duke marrë në konsideratë potencialin e financimit të siguruar dhe të pasiguar dhe likuiditetin e asetëve. Në përgjithësi, aplikohen skontime në të gjitha pozicionet e zbutësve të likuiditetit. Këto skontime përfshijnë skontimin e të rrezikut të tregut dhe skontimin e Bankës Qendrore. Skontimi i rrezikut të tregut paraqet luhatshmërinë e mundshme të çmimeve të letrave me vlerë të mbajtura si aktive si pjesë e zbutësve të likuiditetit gjatë 20 ditëve të ardhshme, ndërsa skontimi i Bankës Qendrore paraqet një skontim shtesë nga Banka Qendrore që mund të ofrohet si kolateral. Kriteret e pranueshmërisë në nivel grupi marrin në konsideratë kufizimet e kreditimit brenda grupit, si p.sh. kufiri ligjor i huadhënies.

Administrimi i Likuiditetit brenda ditës

Në përputhje me kërkesat rregullatore për administrimin e likuiditetit brenda ditës, Departamenti i Tregtisë përbush kërkesat e mëposhtme:

- Përbushja e kërkesave ligjore bankare për likuiditet (kërkesat e rezervës minimale);
- Optimizimi i flukseve dalëse të likuiditetit, kostove të financimit dhe kthimit nga investimeve;

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)

- Ofrimi i fondeve në dispozicion për pagesat në dalje në llogaritë NOSTRO me bankat korrespondente;
- Ndjekja dhe raportimi i vazhdueshëm i situatës së likuiditetit në tregu.

Departamenti i Tregut të Parave si pjesë e Departamentit të Tregtisë është përgjegjës për të administruar nevojat ditore për likuiditet dhe për të administruar rrezikun afatshkurtër të likuiditetit në monedhën vendase dhe në valutë. Thesari merr informacion për të gjitha pagesat kombëtare dhe ndërkombëtare nga departamentet e tjera dhe parashikon fondet në dispozicion në llogarinë tonë NOSTRO me datë valutë T+2, por mund të ndodhë të ngrihen kërkesa të veçanta për datë valutë T+1, T+0. Për të gjitha pagesat në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të respektohet koha e përcaktuar e Grupit deri në momentin që transaksioni të ketë përfunduar. Për pagesat në monedhën vendase, orari i fiksuar nga Banka e Shqipërisë (BSH) është 3.30 pas dite. Për pagesat në valutë të huaj orari i fiksuar është 4:30 pasdite.

Grupi përdor sistemin AIPS (Sistemin e Pagesave Ndërbankare Shqiptare) si platformë për monitorimin online të llogarisë tonë Nostro me Bankën e Shqipërisë për të gjitha pagesat / të ardhurat në monedhën vendase LEK. Monitorimi i llogarive tona Nostro në monedhë të huaj bëhet duke përdorur platforma online, të cilat lehtësojnë administrimin e përditshëm të likuiditetit. Çdo ditë, nga sistemi kryesor bankar MIDAS ngrihen pyetje të cilat përdoren për administrimin e përditshëm të likuiditetit.

Platforma negociuese Reuters përdoret për të hyrë në marrëveshje tregtare në tregun ndërbankar. Departamenti i Tregut të Parave është përgjegjës për të siguruar fonde të mjaftueshme për pagesat e kryera në çdo datë valutë. Informacioni kryesor mbi pagesat e kryera merret me postë elektronike nga Njësia e Proçedimit të Pagesave dhe SWIFT-eve (Departamenti i Operacioneve Qendrore dhe Administrimit të Objekteve) me datë valutë T+2 dhe kur bëhet me kërkesë specifike me datë valutë T+0.

Pozicioni i likuiditetit të Grupit monitorohet dhe përditësohet pas çdo transaksioni të kryer gjatë ditës. Shoqëria e monitoron pozicionin e likuiditetit duke përdorur excel-in dhe duke e përditësuar atë manualisht me informacionin e marrë nga burime të ndryshme si Njësia e Proçesimit të Pagesave dhe SWIFT-ve (Departamenti i Administrimit të Operacioneve Qendrore dhe Departamenti i Financave të Tregtisë dhe Financimit Afatshkurtër), Zyra e Thesarit (Departamenti i Operacioneve dhe Departamenti i Administrimit të Objekteve), Departamenti i Këmbimit Valutor, Departamenti i Korporatave.

Likuiditeti i tepërt në monedhë të huaj investohet si afatshkurtër në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar. Departamenti i Tregtisë është përgjegjës për administrimin e likuiditetit në monedhën vendase dhe në valutë për të gjithë bankën, e jo për çdo degë në mënyrë të veçantë. Departamenti i Tregut të Parave merr kërkesë për fonde për pagesat e klientëve në baza ditore dhe siguron likuiditetin e nevojshëm. Shoqëria po përdor monitorimin e platformave online për shumicën e llogarive NOSTRO për të kontrolluar të gjitha transaksionet e kryera në këto llogari. Pozicioni i mbyllur për çdo llogari NOSTRO merret me postë nga Departamenti SWIFT-eve (në mëngjes) nëpërmjet mesazhit MT 950. Pozicioni i çdo llogarie LORO përgatitet nga Departamenti i Letrave me Vlerë, Investigimit, Rakordimeve dhe Suportit në frekuenca të ndryshme siç është rënë dakord me secilin prej tyre dhe dërgohet nga SWIFT-i nëpërmjet MT 950.

Plani i Financimit Emergjent

Në kushtet e një vështirësie likuiditeti, Grupi kalon në një proces emergjence në të cilin ndjek planin e emergjencës së parakohshme të likuiditetit. Këto plane të emergjencës përbëjnë një element në kuadrin e administrimit të likuiditetit dhe janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Grupit RBI. Procesi i administrimit të emergjencave është hartuar në mënyrë që Grupi të mund të mbajë një pozicion të fortë likuiditeti edhe në situata serioze krizash.

Pozicioni i Likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të Grupit ngrihet mbi një bazë të fortë të depozitave të klientëve të plotësuar me financimin në shuma të mëdha. Instrumentet e financimit janë të diversifikuar siç është më e përshtatme dhe përdoren në raste nevoje. Aftësia për të siguruar fondet monitorohet dhe vlerësohet saktësisht nga Departamenti e Thesarit / Tregtisë, Shitjet e Thesarit, si dhe nga Departamenti i Kërkimeve dhe KAP.

Në vitin e kaluar dhe deri më sot, likuiditeti i Grupit ka qënë në mënyrë të konsiderueshme mbi të gjitha kufijtë rregullatorë dhe kufijtë e brendshëm. Rezultati për testin e stresit të brendshëm në kohë reale tregon se Grupi do të mbijetonte gjatë fazës së stresit të modeluar prej disa muajsh edhe pa aplikuar masat e emergjencës. Raporti i "Parimit të vazhdimësisë" tregon pozicionin strukturor të likuiditetit, e cila mbulon të gjithë nxitësit e rrezikut material të cilat mund të japin ndikim në Grup sipas një skenari të zakonshëm biznesi.

Rezultatet e skenarit të parimit të vazhdimësisë tregohen në tabelën në vijim, ku paraqitet likuiditeti i tepërt dhe raporti i flukseve hyrëse të pritshme të mjeteve monetare plus kapacitetin e kundërbalancimit ndaj daljeve të parave të gatshme (raporti i likuiditetit) për maturitetet e përzgjedhura në baza kumulative.

Bazuar në supozimet e ekspertëve, analizat statistikore dhe specifikat e vendit, kjo përlllogaritje përfshin edhe vlerësimet e stabilitetit të bazës së depozitave të klientëve, daljet nga zërat jashtë pozicionit financiar dhe lëvizjet e tregut në rënie në raport me pozicionet që ndikojnë në kapacitetin kundërbalancues të likuiditetit.

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)

në mijë LEK	2019		2018	
Maturiteti	1 muaj	1 vit	1 muaj	1 vit
Hendeku i Likuiditetit	83,226,992	108,505,744	85,444,619	113,180,699

Raporti i mbulimit të likuiditetit (RML)

Raporti i mbulimit të likuiditetit (RML) i referohet përqindjes së aktiveve shumë likuide (HQLAs) të mbajtura nga Grupi për të përmbushur detyrimet potenciale të shoqëruara me flukse dalëse (detyrimet afatshkurtra). HQLAs mund të konvertohet në para në dorë për të plotësuar nevojat e likuiditetit për një minimum prej 30 ditë kalendarike në skenarin e stresit të likuiditetit.

Llogaritja e hyrjeve dhe daljeve të pritshme të fondeve dhe HQLAs bazohet në specifikimet rregullatore. Në vitin 2018, kufiri rregullator për RML u rrit në nivelin aktual prej 100 përqind. Në vitin 2019, u rrit në nivelin aktual prej 100 përqind.

në mijë LEK	2019	2018
Aktivet likuide mesatare	60,546,699	64,423,880
Daljet neto	6,996,354	6,797,055
Hyrjet	44,207,579	38,180,213
Daljet	27,985,418	27,188,218
Raporti i Mbulimit të Likuiditetit	865%	948%

Raporti i financimit të qëndrueshëm neto (RFQN)

RFQN është përcaktuar si përqindje e Financimit të Qëndrueshëm në Dispozicion ("FQD") nëpërmjet detyrimeve mbi Financimin e Qëndrueshëm të Kërkuar ("FQK") për aktivet. Burimet e Financimeve të Qëndrueshme në Dispozicion përfshijnë: depozitat e klientëve, financimet afatgjata me shumicë (nga tregu ndërbankar i huasë), dhe kapitali.

në mijë LEK	2019	2018
Financimi i Qëndrueshëm i Kërkuar	198,034,542	153,856,045
Financimi i Qëndrueshëm në Dispozicion	263,841,692	212,873,943
Raporti i financimit të qëndrueshëm	133%	138%

Raporti i mbulimit të likuiditetit dhe Raporti i financimit të qëndrueshëm janë paraqitur në takimet e KAP në baza mujore. Grupi synon të sigurojë konsistencë midis likuiditetit dhe kërkesave të Bazel III.

Rreziku i likuiditetit nga financimi

Rrezikut i likuiditetit nga financimi është nxitur kryesisht nga ndryshimet në strategjinë e rrezikut të huadhënësve ose nga një përkeqësim në aftësinë kreditore të një banke që ka nevojë për financim të jashtëm. Normat e financimit dhe rritja ose rënia e ofertës me përhapjen e kredisë, ndryshojnë për shkak të situatës specifike të tregut ose Grupit.

Si pasojë, financimi afatgjatë varet nga rikthimi i besimit në banka dhe rritja e përpjekjes në mbledhjen e depozitave të klientëve. Aktivitetet bankare financohen duke kombinuar fondet e depozitave të individëve dhe fondet nga shitja me shumicë. Në planet e financimit të Grupit, një vëmendje e veçantë i kushtohet strukturës së ndryshme të financimit për të zbutur rrezikun e likuiditetit nga financimi. Masat e financimit me shumicë në Grup janë përgjegjësi e Departamentit të Shitjes së Thesarit dhe Departamentit IB, ku Menaxheri i Financimit është Z. Christian Canacaris, Drejtori Ekzekutiv i Grupit. Gjatë këtij procesi kontrollohet hendeku midis aktiveve dhe detyrimeve dhe rishikohet nëse ka nevoja për financim. Megjithatë, për shkak të faktit se Grupi jonë ka patur gjithmonë likuiditete të tepërta, ka treguar nevoja minimale për financim brenda Grupit. E vetmja marrëveshje financimi është kredia me RBl-në.

Më tej, për të pasur një RWA më të optimizuar të portofolit, Grupi ka lidhur një marrëveshje me RBl për një garanci të lëshuar nga MIGA (grupi i Bankës Botërore) në mënyrë që rezerva jonë minimale të llogaritet me 0 peshë të rrezikut në portofol. Procesi i raportimit dhe monitorimit për të dyja këto marrëveshje bëhet nga Departamenti i Thesarit dhe Departamenti IB.

35. ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)

Tabela e mëposhtme tregon një ndarje të flukseve të mjeteve monetare sipas maturitetit kontraktual të aktiveve financiare:

2019 Në mijë Lek	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Aktivët financiarë jo-derivativë	217,044,764	227,825,802	73,156,049	60,198,623	73,991,689	20,479,443
Arka, banka qendrore dhe llogarite pa afat	25,068,597	25,068,597	25,068,597	-	-	-
Hua dhe paradhenie	129,525,199	140,309,370	42,566,623	39,436,234	37,966,462	20,340,053
Banka qendrore	6,085,715	6,085,715	6,085,715	-	-	-
Institucione shtetërore	21,342	21,342	21,342	-	-	-
Bankat	28,599,932	28,599,932	28,599,932	-	-	-
Korporata të tjera financiare	61	61	61	-	-	-
Korporatat jofinanciare	56,024,507	58,376,303	5,470,984	32,417,097	17,565,522	2,922,701
Individet	38,793,642	47,226,017	2,388,589	7,019,137	20,400,940	17,417,352
Letrat me vlerë të borxhit	62,450,968	62,447,835	5,520,829	20,762,389	36,025,227	139,390
Institucione shtetërore	54,436,807	54,433,674	5,520,829	20,762,389	28,011,066	139,390
Bankat	8,014,161	8,014,161	0	0	8,014,161	0

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të maturimit të flukseve monetare të paskontuara sipas maturitetit kontraktual të pasiveve financiare:

2019 Në mijë Lek	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Detyrimet financiare jo-derivativë	212,474,117	61,576,871	41,368,896	10,625,104	7,153,232	2,429,640
Depozitat	194,128,938	46,124,319	43,020,070	2,719,596	341,836	42,816
Banka qendrore	-	-	-	-	-	-
Institucione shtetërore	3,959,611	3,959,611	3,959,611	-	-	-
Bankat	4,791,034	4,837,435	2,916,545	1,920,890	-	-
Korporata të tjera financiare	3,636,469	3,637,300	2,878,431	634,931	123,938	-
Korporatat jofinanciare	29,605,062	29,605,303	29,180,814	163,775	217,898	42,816
Individet	152,136,762	152,139,505	119,107,319	31,640,131	1,146,882	245,173
Llogari të tjera financiare	18,920	18,920	18,920	-	-	-
Garanci financiare të dhëna dhe marrëveshje të tjera	5,010,785	5,010,785	733,858	3,158,082	1,118,845	-
Marrëveshje për kredi të dhëna	13,315,474	13,315,474	488,674	4,747,426	5,692,551	2,386,824

36. RREZIKU OPERACIONAL

Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjeve që rezultojnë nga proceset brendshme të papërshtatme ose të dështuara, njerëz dhe sisteme, ose nga ngjarje të jashtme, përfshirë rrezikun ligjor. Në këtë kategori rreziku, nxitësit e rrezikut të brendshëm, siç janë aktivitetet e paautorizuara, mashtrimet ose vjedhjet, humbjet e lidhura me sjelljen, gabimet e modelimit, gabimet në ekzekutim dhe procesim, apo ndërprerjet e biznesit dhe dështimet e sistemit mund të administrohen. Gjithashtu, mund të administrohen dhe kontrollohen edhe faktorët e jashtëm siç janë dëmtimi i pasurisë fizike ose mashtrimi.

Kjo kategori rreziku është analizuar dhe administruar bazuar në të dhënat historike të humbjeve dhe rezultatet e vlerësimeve të rrezikut.

Ashtu si me llojet e tjera të rrezikut, parimi i "firewalling" për administrimin e rrezikut dhe kontrollit aplikohet edhe për rrezikun operacional të Grupit. Me këtë qëllim, janë përzgjedhur dhe trajnuar si Menaxhues të Rrezikut Operacional disa individë në secilën fushë biznesi. Menaxherët e Rrezikut Operacional sigurojnë Kontrollin Qendror të Rrezikut Operacional nëpërmjet raporteve mbi vlerësimet e rrezikut, ngjarjet e humbjes, treguesit dhe masat e marra. Ato mbështeten në punën e specialistëve të dedikuar të rrezikut operacional (DORS).

Njësitë kontrolluese të rrezikut operacional janë përgjegjës për raportimin, zbatimin e kuadrit, zhvillimin e masave të kontrollit dhe monitorimin e përmbushjes së kërkesave. Brenda kuadrit të ciklit vjetor të administrimit të rrezikut, koordinohet edhe pjesëmarrja e linjës së dytë përkatese të departamenteve të mbrojtjes (Administrimi i Krimin Financiar, Përputhshmëria, Administrimi i Furnitorëve, Administrimi i Transferimeve, Administrimi i Sigurimeve, Siguria e Informacionit, Siguria Fizike, BCM, Sistemi i Kontrollit të Brendshëm) dhe të gjithë linjat e para të partnerëve të mbrojtjes (Menaxherët e Rrezikut Operacional).

Identifikimi i rrezikut

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që mund të rrezikojnë ekzistencën e Grupit (por ndodhja e të cilave është pothuajse e pamundur) dhe zonat ku humbjet kanë më shumë gjasa të ndodhin më shpesh (por kanë ndikim të kufizuar) janë aspekte të rëndësishme të administrimit të rrezikut operacional.

Vlerësimi i rrezikut operacional realizohet në mënyrë të zgjeruar, të njëtrajtshme dhe të strukturuar për Bankën sipas kategorive të rrezikut siç janë proceset e biznesit dhe llojet e ngjarjeve. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut vlen edhe për produktet e reja. Të gjitha njësitë e Grupit vlerësojnë ndikimin e probabilitetit të lartë/ndikimit të ulët të ngjarjeve dhe probabilitetit të ulët/ ndikimit të lartë të incidenteve sipas vlerësimit të tyre të potencialit të humbjes për vitin e ardhshëm dhe në dhjetë vitet në vijim. Për ngjarjet me probabilitet të ulët/ ndikim të lartë përdoret një instrument analitik i Grupit (me skenarë). Profili i rrezikut të brendshëm, humbjet dhe ndryshimet e jashtme përcaktojnë se cilat raste duhet të trajtohen në detaje.

Monitorimi

Për të monitoruar rreziqet operationale përdoren indikatorë të paralajmërimit të hershëm që lejojnë identifikimin e shpejtë dhe minimizimin e humbjeve.

Të dhënat mbi humbjet grumbullohen në një bazë të dhënash qendrore të quajtur AKRO (Aplikacioni i Kontrollit të Rrezikut Operacional) në një mënyrë të strukturuar dhe në nivel bankash sipas llojit të ngjarjes dhe të biznesit. Përveç kërkesave për raportim të brendshëm dhe të jashtëm, informacionet mbi ngjarjet e humbjes krahasohen me të dhënat ndërkombëtare për të zhvilluar më tej menyrën e administrimit të rrezikut operacional, si dhe për të ndjekur masat e marra dhe efektivitetin e kontrollit. Që nga viti 2010, Grupi ka qenë pjesëmarrëse në grumbullimin e të dhënave të ORX (Shoqata e Shkëmbimit të të Dhënave të Rrezikut Operacional), të dhënat e të cilës aktualisht përdoren për qëllime dhe analiza të brendshme dhe si pjesë e modelit të rrezikut operacional. ORX është një shoqatë bankash dhe sigurimesh për qëllime statistikore. Rezultatet e analizave si dhe ngjarjet që rezultojnë nga rreziqet operationale janë raportuar në baza të rregullta në një mënyrë gjithëpërfshirëse në Komitetin e administrimit dhe Kontrollit të Rrezikut Operacional të përshtatshëm dhe Komitetin e Kontrollit të Rrezikut Operacional të Grupit RBI.

Saktësimi dhe zbutja e rreziqeve

Që nga tetori 2016, veprimtaritë me rrezikun operacional ndërmerren nga Administrimi i Krimin Financiar. Administrimi i Krimin Financiar siguron një mbështetje për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit. Grupi gjithashtu ka zhvilluar një program trajnimi të gjerë të stafit dhe ka plane të ndryshme emergjencash dhe sisteme mbështetëse rezervë.

INFORMACIONE TË TJERA

37. QIRATË OPERATIVE

Qiratë operative nga pikëpamja e qiradhënësit

Pagesat e ardhshme minimale të qirasë sipas qirasë operative të pa-anullueshme janë si më poshtë:

Në mijë Lek	2019	2018
Deri në 1 vit	14,780	4,098
Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	0	1,488
Total	14,780	5,586

Qiratë operative nga pikëpamja e qiramarrësit

Pagesat e ardhshme minimale të qirasë sipas qirasë operative të pa-anullueshme janë si më poshtë:

Në mijë Lek	2019	2018
Deri në 1 vit	278,354	165,731
Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	698,008	419,356
Më shumë se 5 vjet	333,926	
Total	1,310,288	585,087

38. PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura (shoqëritë dhe individët) janë të kufizuara në transaksionet e biznesit bankar që kryhen në kushte të tregut të drejtë. Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura (individët) raportohen në shënim (40) Marrëdhëniet me drejtimin kryesor.

Në mijë Lek	2019	2018
Aktivet financiare të përzgjedhura		
Instrumentet e kapitalit	329,205	329,205
Letrat me vlerë të borxhit	4,358,605	10,610,151
Hua dhe paradhenie	7,846,769	9,916,810
Aktivet tjera	85,225	5,962
Detyrimet financiare të përzgjedhura		
Depozitat	1,875,236	1,955,617
Provizionet dhe detyrimet e tjera	60,383	59,723
Angazhimet e huasë, garancitë financiare dhe angazhimet e tjera të dhëna	1,485,036	2,195,238
Në mijë Lek	2018	2017
Të ardhurat nga interesi	149,197	147,867
Shpenzimet e interesit	-114,918	-367,014
Të ardhurat nga dividendi	0	-
Të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet	673	1,725
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	-181,675	-158,694

39. NUMRI MESATAR I STAFIT

Ekivalentë me kohë të plotë	2019	2018
Punonjësit me pagë	1,215	1,251
Punonjësit e pagave	40	40
Total	1,255	1,291

40. MARRËDHËNIET ME DREJTIMIN KYÇ

Marrëdhëniet e Grupit me drejtimin kyç

Në mijë Lek	2019	2018
Aktivët	212,318	192,842
Detyrimet	121,647	196,692

Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Drejtues

Tabela e mëposhtme tregon shpërblimin total të anëtarëve të Bordit Drejtues sipas SNK 24.17. Shpenzimet sipas SNK 24 u njohën në bazë akruale dhe sipas rregullave të standardeve bazë (SNK 19 dhe SNRF 2).

Në mijë Lek	2019	2018
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve	242,486	196,053
Përfitimet pas punësimit	0	
Përfitime të tjera afatgjata	53,518	32,683
Përfitimet e ndërprerjes	0	
Total	296,004	228,736

Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës

Në mijë Lek	2019	2018
Bordi Mbikëqyrës i Shpërblimit	15,681	16,879

41. BORDI DREJTUES

Bordi Drejtues më 31 dhjetor 2019 ishte si më poshtë:

Antarët e Bordit Drrejtues	Detyra e parë	Fund periudhe
Christian Canacaris	01/10/2010	31/12/2024
Alexander Zsolnai	27/04/2010	31/12/2024
Lyubomir Punchev	18/10/2019	30/06/2023
Elona Mullahi	09/10/2015	30/06/2021
Egon Lerchster	13/11/2017	31/12/2020

41. BORDI DREJTUES (VAZHDIM)

Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës më 31 dhjetor 2019 ishte si vijon:

Antarët e Bordit Mbikëqyrës	Detyra e parë	Fund periudhe
Peter Lennkh	07/07/2017	09/03/2021
Heinz Wiedner	10/07/2012	10/03/2020
Slavoljub Dordevic	24/01/2019	23/01/2023
Harald Kreuzmair	08/08/2014	08/08/2022
Andreas Engels	27/01/2011	08/08/2022

INFORMACION PËR AUTORITETIN MBIKËQYRËS

42. ADMINISTRIMI I KAPITALIT DHE KAPITALI TOTAL

Objektivat e Grupit lidhur me administrimin e kapitalit janë: (i) të jetë në përputhje me kërkesat për kapitalin të përcaktuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe (ii) të mbrojë aftësinë e Grupit për të vijuar aktivitetin e saj.

Kapitali ligjor

Grupi monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur, ndër të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSH"), e cila përcakton kapitalin ligjor të kërkuar për të mbështetur biznesin. Rregullorja "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" është krijuar në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe "Ligjin Bankar të Republikës së Shqipërisë".

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është përqindja e kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik dhe zërave jashtë bilancit, shprehur në përqindje. Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%.

Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është përqindja e kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik dhe zërave jashtë bilancit, të shprehura në përqindje. Raporti minimal i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%.

Aktivitetet e ponderuara me rrezik (APRR)

Aktivitetet janë të ponderuara me rrezik sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke u caktuar një peshë rreziku sipas shumës së kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Janë aplikuar pesë kategori të peshave të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%, 150%); për shembull, mjetet monetare dhe instrumentet e tregut të parasë kanë një peshë zero të rrezikut, që do të thotë se nuk kërkohet asnjë kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Ndërtesat dhe pajisjet mbartin një peshë 100% të rrezikut, që do të thotë se duhet të mbështetet nga kapitali i barabartë me 12% të vlerës kontabël.

Janë marrë parasysh edhe marrëveshjet e angazhimit të lidhura me kredinë, si mjete financiare jashtë bilancit. Shumat më pas u caktohen një peshë rreziku duke përdorur të njëjtat përqindje si për aktivet në bilanc.

42. ADMINISTRIMI I KAPITALIT DHE KAPITALI TOTAL (VAZHDIM)

Në mijë Lek	2019	2018
Totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	120,195,660	113,098,889
Kapitali rregullator	23,247,305	23,270,769
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	19.34 %	20.58 %

Politika e Grupit është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe të tregut si dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen. Grupi e njeh ndikimin e nivelit të kapitalit në kthimin e aksionarëve gjithashtu Grupi njeh nevojën për të ruajtur një balancë midis kthimeve më të larta që mund të jenë të mundshme nëpërmjet një niveli më të lartë borxhi dhe avantazhet dhe sigurinë e përfituar nga një pozicioni i shëndoshë kapitali.

Grupi ka përbushur të gjitha kërkesat e kapitalit të përcaktuara nga institucioni rregullator ("Banka e Shqipërisë") gjatë gjithë periudhës. Nuk ka pasur ndryshime materiale në administrimin e kapitalit të Grupit gjatë periudhës.

PARIMET E NJOHJES DHE MATJES

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare

Sipas SNRF 9, të gjitha aktivet financiare, detyrimet financiare dhe instrumentet financiare derivative duhet të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Një instrument financiar përcaktohet si çdo kontratë nga e cila buron një aktiv financiar në një njësi ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali neto në një njësi ekonomike tjetër. Në njohjen fillestare, instrumentet financiare duhet të maten me vlerën e drejtë, e cila në përgjithësi korrespondon me çmimin transaksionit në kohën e blerjes ose emetimit. Sipas SNRF 13, vlera e drejtë përcaktohet si çmimi i daljes. Ky është çmimi që do të zbatohet në shitjen e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Për matjen vijuese, instrumentet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kategorisë përkatëse të matjes sipas SNRF 9, qoftë me kosto (të amortizuar) ose me vlerën e drejtë.

SNRF 9 përmban një metodë klasifikimi dhe matjeje e cila bazohet fillimisht në modelin e biznesit sipas të cilit administrohet aktivi dhe së dyti në karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktiveve. Për Bankën, kjo rezulton në pesë kategori klasifikimi për aktivet financiare:

- Pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar (KA)
- Pasuritë financiare të matura me vlerë të drejtë përmes ATGJ (VDNATGJ)
- Pasuritë financiare të detyrueshme të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDNFH)
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDNFH) dhe
- Vlera e drejtë e aktiveve financiare përmes fitimit ose humbjes (VDNFH)

Në Grup, një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse objektivi është mbajtja e aktivitetit për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e përcaktuara flukse mjetesh monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interes mbi principalin e papaguar. Një aktiv vlerësohet në vijimësi me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ) nëse ajo mbahet brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është si mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare. Përveç kësaj, kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e përcaktuara flukse mjetesh monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesi mbi principalin e papaguar.

Në njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për qëllime tregtimi, Grupi mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme të paraqesë ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse (ATG). Këto zgjedhje bëhen në bazë investim-pas-investimi për secilin investim dhe në thelb mbulon interesa strategjike që nuk janë plotësisht të ndara.

Të gjitha aktivet e tjera financiare - p.sh. aktivet financiare që nuk plotësojnë kriteret për klasifikim si më pas të matura

me koston e amortizuar ose VDNATGJ - klasifikohen si më pas të matura me vlerën e drejtë, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohur në fitim ose humbje. Përveç kësaj, Grupi ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar si në VDNFH nëse në këtë mënyrë eliminon ose redukton në mënyrë të konsiderueshme mospërputhjen midis matjes ose të njohjes - dmth një 'mospërputhje kontabiliteti' - që përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose duke njohur fitimet dhe humbjet në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen fillestare.

Paraqitja e detyrimeve financiare është kryesisht në përputhje me rregullat e SNK 39, me përjashtim të faktit që ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve të matura me vlerën e drejtë të cilat janë shkaktuar nga ndryshimet në rrezikun e kredisë së vetë Grupit, të cilat duhet të regjistrohen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në përputhje me SNRF 9, derivativët e përfshirë nuk janë të ndara nga kontrata bazë e një aktivi financiar. Përkundër, aktivet financiare klasifikohen në përputhje me modelin e biznesit dhe karakteristikat e tyre kontraktuale siç është shpjeguar në kapitullin e vlerësimit të modelit të biznesit dhe në kapitullin Analiza e karakteristikave të rrjedhës kontraktuale të parasë. Njohja e derivativëve të përfshirë në detyrimet financiare dhe në kontratat e organizatave jofinanciare nuk ka ndryshuar në SNRF 9.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Grupi bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në një nivel portofoli, sepse kjo reflekton më së miri mënyrën se si administrohet biznesi dhe informacioni i ofrohet drejtimin. Faktorët e mëposhtëm konsiderohen si prova kur vlerësojnë se cili model biznesi është i zbatueshëm:

- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli të biznesit) dhe mënyrën se si administrohen ato rreziqe;
- Si janë kompensuar menaxherët e biznesit - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të administruara ose të flukseve monetare kontraktuale të mbledhura;
- Shpeshësia, vlera dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes; dhe
- Nëse aktiviteti i shitjes dhe arkëtimi i flukseve monetare kontraktuale janë secila pjesë përbërëse ose e rastësishme ndaj modelit të biznesit ("mbajtja për të arkëtuar" kundrejt modelit "të mbajtur dhe shitur" të biznesit).

Aktivitetet financiare që mbahen për qëllime tregtimi dhe ato të cilat administrohen dhe performanca e të cilave vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë, do të maten në VDNFH.

Objekti i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e mjeteve financiare për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale edhe kur ka ndodhur ose pritet që të ndodhin disa shitje të aktiveve financiare. Për Grupin, shitjet vijuese mund të jenë në përputhje me modelin e mbajtjes për arkëtim të biznesit:

- Shitjet janë për shkak të rritjes së rrezikut të kredisë të një aktivi financiar;
- Shitjet janë të rralla (edhe nëse janë të rëndësishme), ose janë të parëndësishme individualisht dhe në tërësi (edhe nëse janë të shpeshta);
- Shitjet bëhen afër afatit të maturimit të aktivitetit financiar dhe të ardhurat nga shitjet afrohen me arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale të mbetura.

Për Grupin, shitja e më shumë se 10 për qind të portofolit (vlera kontabël) gjatë një periudhe tre vjeçare do të konsiderohet potencialisht "më e madhe se e rrallë", përveç nëse këto shitje janë jo materiale në tërësi.

Analiza e karakteristikave të rrjedhës kontraktuale të parasë

Pasi Grupi të përcaktojë se modeli i biznesit i një portofoli specifik është mbajtja e mjeteve financiare për të arkëtuar flukse kontraktuale monetare (ose për të dyja arkëtimin e flukseve kontraktuale monetare dhe për të shitur aktivitetet financiare), atëherë duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përcaktojnë data specifike për flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar. Për këtë qëllim, interesi përkufizohet si shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kredisë që shoqërohet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet në bazë instrumentesh-pas-instrumentit në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Grupi i konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë që ajo të mos plotësojë më këtë kusht. Grupi konsideron:

- Parapagim, zgjatje afati
- Efektet e Levës
- Kërkesa është e kufizuar në Aktivet e specifikuar ose flukset e mjeteve monetare
- Instrumentet e lidhura në mënyrë kontraktuale

Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe test bazë

Vlera kohore e parave është elementi i interesit që merret në konsideratë vetëm për kalimin e kohës. Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditetit etj.) ose kostot (administrative, etj.) e lidhura me mbajtjen e një aktivi financiar. Në disa raste, elementi i vlerës së kohës së parasë mund të modifikohet (e papërsosur). Kjo do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit të një aktivi financiar ndryshon periodikisht, por frekuenca e ndryshimit nuk përputhet me maturitetin e interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin nëse flukset monetare kontraktuale ende përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit, p.sh. termi i modifikimit nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument 'i përsosur'. Ky vlerësim nuk është një zgjedhje e politikës kontabël dhe nuk mund të shmanget thjesht duke konkluduar që një instrument, në mungesë të një vlerësimi të tillë, do të matet me vlerën e drejtë.

Një test bazë zbatohet për karakteristikat e mëposhtme kontraktuale kryesore që potencialisht mund të modifikojnë vlerën kohore të parasë:

- Frekuenca e ndryshimit nuk përputhet me maturitetin e interesit
- Treguesi i zhvendosjes
- Klauzolën zbutëse
- Periudha Grace
- Norma e referuar tregut sekondar

Aktivitet dhe detyrimet financiare

Aktivitet financiare - kostoja e amortizuar

Në Grup një aktiv financiar matet me koston e amortizuar (KA) nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve me qëllim të arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale
